



# Raport Vlerësimi i PZHK-së (2009-2025+) së Mitrovicës Jugore

Dhjetor 2018



INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME  
PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS  
PROGRAM SVEOBUH VATNOG RAZVOJA

Program i implementuar nga:

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

**PAX**

**CBM**  
Community Building Mission

dhe mbështetur nga::

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**







# RAPORT VLERËSIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK-së) SË MITROVICËS JUGORE

## MITROVICË JUGORE

### PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

Implementuar nga:



Financuar nga:

SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION



Komuna e Mitrovicës Jugore/Municipality of Mitrovica South

Rr. "Bedri Gjinaj" – 40000 Mitrovicë

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat)

Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës

Ndërtesa e Ministrive Rilindja, Kati 10, 10000 Prishtinë, Kosovë

[www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

[www.unhabitat-kosovo.org](http://www.unhabitat-kosovo.org)

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2018

## FALËNDERIME

Fotot, hartat dhe diagramet mund të riprodhohen me kushtin që burimi të shtypet bashkë me fotot, hartat ose diagramet.

**Redaktorët kryesorë të raportit:** Zana Sokoli, Fjollë Caka, Klodeta Krasniqi

**Kontribues të raportit:** Blinera Haxhani, Korab Vranovci

**Recenzioni:** Gwendoline Mennetrier

Të gjitha pjesët e këtij raporti janë hartuar dhe shkruar bazuar në punën e gjerë të ndërmarrë nga grupi punues i Vlerësimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Mirënjohje dhe falënderime për Ekipin Komunal të Planifikimit dhe kontribuesit e tjerë komunalë dhe të shoqërisë civile që punuan bashkërisht dhe profesionalisht në mbështetje të hartimit të këtij raporti.

**Besnik Beka** (zyrtarisht **Sami Zeka**), Drejtor, Drejtorja për Urbanizem dhe Planifikim Hapësinor dhe **Egzon Jashari**, Drejtor, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - anetarë në Këshillin Drejtues të Programit, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës.

**Nexhmi Hasani**, Shef i Planifikimit, Drejtorja për Urbanizem dhe Planifikim Hapësinor - Koordinator i grupit të vlerësimit të PZHK-së në emër të komunës së Mitrovicës Jugore

grupi punues për Vlerësimin e PZHK-së:

Nexhmi Hasani (EKP), Florent Abrashi (EKP), Fatime Beqiri (EKP), Fisnik Citaku (EKP), Berat Jashari (EKP), Hysnije Mikullovc (EKP), Sheriban Nuhi (EKP), Besa Veseli (EKP), Mehmet Bajrami (Kontribues substancial), Lulzim Hakaj (Kontribues nga OJQ), Gjylferije Ademi (EKP), Erduan Jashari (EKP), Irfan Peci (EKP), Anesa Mustafa (Praktikante DPU), Adem Fazliu (EKP), Idriz Beqiri (EKP), Fisnik Ibrahim (EKP), Blerim Mehulli (Bahtir Maxhuni) (EKP), Haxhimet Ferati (EKP), Artan Ibishi (Praktikant DI),

Shemsedin Bajrami (EKP), Besim Shala (EKP), Vehbi Ahmeti (EKP), Shyhrete Peci (Kontribuese substanciale), Blinera Haxhani (Praktikante DPU).

**Zana Sokoli**, Planere Urbane, Koordinatore e grupit të vlerësimit të PZHK-së në emër të UN-Habitat Kosovo

Aktivitetet në kuadër të vlerësimit si punëtoritë e ndryshme, takimet e grupeve punuese etj., janë mbështetur dhe asistuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht,

**Suzana Goranci**, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, MMPH dhe

**Arbën Rrecaj**, Shef i sektorit për Hulumtim dhe Vlerësim, Instituti për Planifikim Hapësinor, MMPH

## Përmbajtja

Lista e akronimeve .....	7
Lista e hartave .....	8
Lista e tabelave.....	8
Lista e grafikoneve .....	9
Lista e fotografive.....	9
Hyrje.....	11
Qëllimi i vlerësimit .....	11
Procesi dhe mjetet e vlerësimit .....	12
<b>1. Pajtueshmëria me kornizën ligjore të planifikimit hapësinor .....</b>	<b>15</b>
<b>1.1. Të dhënat komunale .....</b>	<b>15</b>
<b>1.1.1. Trashëgimia kulturore dhe natyrore .....</b>	<b>18</b>
<b>1.1.2 Demografia .....</b>	<b>19</b>
<b>1.1.3 Vendbanimet .....</b>	<b>19</b>
<b>1.1.4 Vendbanimet joformale .....</b>	<b>19</b>
<b>1.1.5 Banimi .....</b>	<b>19</b>
<b>1.1.6 Infrastruktura sociale dhe shërbimet publike .....</b>	<b>19</b>
<b>1.1.6.1 Institucionet shëndetësore .....</b>	<b>20</b>
<b>1.1.6.2 Institucionet arsimore .....</b>	<b>21</b>
<b>1.1.6.2 Sporti dhe rekreacioni .....</b>	<b>21</b>
<b>1.1.6.4 Institucionet kulturore, fetare dhe administrative .....</b>	<b>22</b>
<b>1.1.6.5 Institucionet e mirëqenies sociale .....</b>	<b>22</b>
<b>1.1.6.6 Hapësirat publike .....</b>	<b>22</b>
<b>1.1.7 Ekonomia .....</b>	<b>23</b>
<b>1.1.8 Infrastruktura dhe shërbimet teknike .....</b>	<b>24</b>
<b>1.1.9 Infrastruktura dhe shërbimet e transportit.....</b>	<b>24</b>
<b>1.1.10 Fatkeqësitë natyrore .....</b>	<b>25</b>
<b>1.1.11 Ndotja mjedisore.....</b>	<b>25</b>
<b>1.1.12 Shfrytëzimi dhe transformimi i tokës .....</b>	<b>26</b>
<b>1.1.13 Kapacitetet administrative dhe financiare .....</b>	<b>27</b>
<b>1.2. Struktura e pjesës tekstuale të PZHK-së.....</b>	<b>28</b>
<b>1.3. Lista dhe përmbajtja e pjesës hartografike të PZHK dhe PZHU .....</b>	<b>28</b>
<b>2. Pajtueshmëria/Zbatimi i PZHK-së, PZHU-së dhe PrrU-ve .....</b>	<b>31</b>
<b>2.1 Mbulueshmëria e zonës urbane me Plane Rregulluese Urbane (PRrU-të) .....</b>	<b>31</b>



2.1.1 Destinimi i tërësive hapësinore në planet rregulluese në nivel urban - dallimet me PZHU-në .....	31
2.1.2 Pajtueshmëria e pjesës tekstuale dhe hartografike të PZHK/PZHU me Planet Rregulluese Urbane (PRrU) .....	34
2.2.1 Përputhshmëria ndërmjet PZHK-së/ PZHU-së me Planet Rregulluese Urbane (PRrU-të) - Rrjeti Rrugor .....	43
2.2.2 Hapësira publike dhe institucionale - Përputhshmëria mes propozimit dhe gjendjes ekzistuese .....	44
<b>3. Pajtueshmëria e projekteve kapitale dhe aktiviteteve të ofrimit të shërbimeve me PZHK/PZHU .....</b>	<b>49</b>
3.1 Drejtoria e Arsimit .....	55
3.2 Drejtoria e Shëndetësisë .....	57
3.3 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë .....	60
3.4 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .....	63
3.5 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural .....	65
3.6 Drejtoritë e tjera .....	67
3.7 Investimet në Mitrovicën Veriore deri në vitin 2012 .....	68
<b>4. Pajtueshmëria e investimeve private (aktivitetet banimore dhe ekonomike) me PZHK/PZHU</b>	<b>71</b>
4.1 Ndërtimet private me leje ndërtimi .....	74
4.2 Ndërtimet private pa leje ndërtimi .....	77
<b>Përfundimet .....</b>	<b>79</b>
<b>Hapat në vijim .....</b>	<b>84</b>

## Lista e akronimeve

**APK** - Agjencia Pyjore e Kosovës  
**ASK** - Agjencia e Statistikave të Kosovës  
**DA** - Drejtoria e Arsimit  
**DAP** - Drejtoria e Administratës së Përgjithshme  
**DBZHR** - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
**DFZHK** - Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik  
**DGJKP** - Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës  
**DH** - Drejtoria e Shëndetësisë  
**DIEMS** - Drejtoria për Integrimin Europian dhe Mirëqenie Sociale  
**DKRS** - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
**DMM** - Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit  
**DMSH** - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim  
**DPH** - Departamenti për Planifikim Hapësinor  
**DPU** - Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizmit  
**DSHPI** - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës  
**EKP** - Ekipi Komunal për Planifikim  
**HZK** - Harta Zonale e komunës  
**IAK** - Instituti Arkeologjik i Kosovës (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)  
**IMM** - Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)  
**ISHP** - Instituti i Shëndetit Publik  
**KEDS** - Kompania Kosovare e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike  
**KIM** - Komuniteti Islamik - Mitrovicë  
**KRU Mitrovica** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovicë  
**MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
**MF** - Ministria e Financave  
**MI** - Ministria e Infrastrukturës  
**MKRS** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
**MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
**MPMS** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
**MV** - Mitrovica Veriore  
**MZHE** - Ministria e Zhvillimit Ekonomik  
**PIK** – Projekt për Investime Kapitale  
**PK** - Policia e Kosovës; Drejtoria Rajonale e Policisë (DRP) Mitrovicë  
**PRrU** - Plani Rregullues Urban  
**PZHK** - Plani Zhvillimor Komunal  
**PZHU** - Plani Zhvillimor Urban  
**QKMF** - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare  
**QPS** - Qendra për Punë Sociale  
**SR** - Spitali Rajonal Dr. Sami Haxhibeqiri  
**SPAK (APHK)** - Aplikacioni për Planifikimi Hapësinor Kosovë  
**Trainkos** - Ndërmarrja publike 'Hekurudhat e Kosovës'  
**ZP** - Zyra e Personelit



## Lista e hartave

- Harta 1: Mbulueshmëria e zonës urbane me plane rregulluese
- Harta 2: Destinimi i tërësive hapësinore sipas PRrU-ve në nivel urban - dallimet me PZHU-në
- Harta 3: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU me PRrU-të, bazuar në kushtet e ndërtimit - E përgjithshme
- Harta 4: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU " Qendra ", bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 5: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Fidanishte', bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 6: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Ilirida', bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 7: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Bair', bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 8: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Ura e Gjakut', bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 9: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Sitnica', bazuar në kushtet e ndërtimit
- Harta 10: Kategorizimi i rrugëve sipas PZHU dhe PRrU-ve - Krahasimi i përputhmërisë
- Harta 11: Krahasimi i përputhshmërisë në mes të rrjetit të rrugëve të përcaktuara me PRrU-të dhe atyre ekzistuese (2018)
- Harta 12 Hapësira publike dhe institucionale - Përputhshmëria mes propozimit dhe gjendjes ekzistuese
- Harta 13: Shpërndarja ndërsektoriale hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera në Komunën e Mitrovicës Jugore
- Harta 14: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria e Arsimit
- Harta 15: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria e Shëndetësisë
- Harta 16: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
- Harta 17: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Harta 18: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Harta 19: Investimet në veri të Mitrovicës deri në vitin 2012
- Harta 20: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje dhe pa leje në komunën e Mitrovicës Jugore
- Harta 21: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje dhe pa leje në qendër të qytetit
- Harta 22: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje në komunën e Mitrovicës Jugore
- Harta 23. Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje - insert nga baza e të dhënave në QGIS e ndërtimeve me leje në qendër të qytetit dhe tabela e attributeve
- Harta 24: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve pa leje në komunën e Mitrovicës Jugore

## Lista e tabelave

- Tabela 1: Informacione themelore
- Tabela 2: Lista e institucioneve me të dhëna që mungojnë
- Tabela 3. Disponueshmëria e të dhënave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Tabela 4. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve të kujdesit shëndetësor
- Tabela 5. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve arsimore
- Tabela 6. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve të sportit dhe rekreacionit
- Tabela 7. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve kulturore dhe fetare
- Tabela 8. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve të mirëqenies sociale
- Tabela 9. Disponueshmëria e të dhënave të hapësirave publike
- Tabela 10. Disponueshmëria e të dhënave të ekonomisë
- Tabela 11. Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën teknike
- Tabela 12. Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën e transportit
- Tabela 13. Disponueshmëria e të dhënave për ndotjen mjedisore
- Tabela 14. Disponueshmëria e të dhënave për shfrytëzimin dhe transformimin e tokës
- Tabela 15. Disponueshmëria e të dhënave për kapacitetet administrative dhe financiare
- Tabela 16/17. Përqindja e përmbushjes së objektivave/strategjive të PZHK/PZHU me anë të projekteve kapitale dhe investimeve tjera

## Lista e grafikoneve

- Grafiku 1: Ofrimi i përgjithshëm i të dhënave
- Grafiku 2: Niveli i disponueshmërisë së të dhënave
- Grafiku 3: Disponueshmëria e të dhënave sipas fushës tematike (%)
- Grafiku 4: Disponueshmëria e të dhënave për trashëgiminë kulturore dhe natyrore (%)
- Grafiku 5: Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën sociale dhe shërbimet publike (%)
- Grafiku 6: Disponueshmëria e të dhënave ekonomike (%)
- Grafiku 7: Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës teknike (%)
- Grafiku 8: Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës së transportit (%)
- Grafiku 9: Disponueshmëria e të dhënave për mbrojtjen mjedisore (%)
- Grafiku 10: Disponueshmëria e të dhënave për shfrytëzimin dhe transformimin e tokës (%)
- Grafiku 11: Disponueshmëria e të dhënave për kapacitetet administrative dhe financiare (%)
- Grafiku 12: Disponueshmëria e të dhënave kartografike
- Grafiku 13: Gjithsej PIK-të nëpër drejtori
- Grafiku 14: PIK-të në drejtori në vit
- Grafiku 15: PIK-të në departamente sipas llojit/funksionit
- Grafiku 16: PIK-të në Drejtorinë e Arsimit në vit
- Grafiku 17: PIK-të për infrastrukturë dhe shërbime
- Grafiku 18: PIK-të në Drejtorinë e Arsimit për vendbanim
- Grafiku 19: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë së Arsimit me Objektivin 3
- Grafiku 20: PIK-të e Drejtorisë së Shëndetësisë për vit
- Grafiku 21: PIK-të për infrastrukturë dhe shërbime
- Grafiku 22: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë së Shëndetësisë me Objektivin 3
- Grafiku 23: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë së Shëndetësisë me Objektivin 4
- Grafiku 24: PIK-të në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës
- Grafiku 25: PIK-të për infrastrukturë dhe shërbime
- Grafiku 26: Lokacioni i PIK-ve
- Grafiku 27: PIK-të në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës për vendbanim
- Grafiku 28: PIK-të në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vit
- Grafiku 29: PIK-të në Departamentin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vendbanim
- Grafiku 30: Objektivat
- Grafiku 31: PIK-të në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vit
- Grafiku 32: PIK-të në infrastrukturë dhe shërbime
- Grafiku 33: PIK-të në departamentet tjera për vit
- Grafiku 34: PIK-të në infrastrukturë dhe shërbime
- Grafiku 35: Përputhshmëria e PIK-ve të departamenteve tjera me objektivat
- Grafiku 36: PIK-të në Mitrovicën Veriore për vit
- Grafiku 37: PIK-të në infrastrukturë dhe shërbim
- Grafiku 38: Përputhshmëria me objektivat
- Grafiku 39: Ndëryrimeve private sipas vitit dhe llojit
- Grafiku 40: Përqindja e ndëryrimeve private ekonomike dhe në banim
- Grafiku 41: Lloji i ndëryrimeve ilegale


## Lista e fotografive

Foto 1. Pjesëmarrësit e punëtorisë për vlerësimin e PZHK-së, Manastir, korrik 2018.

Konteksti Rregjional

Konteksti kosovar

Mitrovica Jugore



## Hyrje

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) për Mitrovicën është dokument i planifikimit hapësinor për periudhën 2009 – 2025+, i cili përcakton qëllimet afatgjate për zhvillimin ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor Urban (PZHU) për Mitrovicën përcakton objektiva më specifike dhe strategji për zbatim, për të njëjtën periudhë kohore. Këto dokumente janë hartuar në vitin 2009 sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (nr. 2003/14) dhe Ligjit nr.03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (nr. 2003/14).

Megjithatë, këto ligje janë shfuqizuar pas aprovimit të Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor (nr. 04/L-174) në vitin 2013. Ligji i ri jep një sistem të ri të planifikimit hapësinor, sipas të cilit kërkohen PZHK më të detajuara dhe prezanton Hartat Zonale Komunale (një koncept dhe praktikë e re në Kosovë), ndër të tjera.

**Tabela 1: Informacione themelore**

Komuna	Zona	Popullsia <sup>1</sup>	Njësitë Administrative
Mitrovica Jugore	331 km <sup>2(2)</sup>	69,346	46
Mitrovica Veriore	~ 5-6 km <sup>2</sup>	12,211	3

Për më tepër, si rezultat i decentralizimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040) dhe Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave (Nr. 03/L-041) në vitin 2008, Komuna e Mitrovicës është ndarë në dy komuna të veçanta: Mitrovica Jugore dhe Mitrovica Veriore në vitin 2013.

Përderisa në PZHK-në aktuale Mitrovica trajtohet si një komunë (Mitrovica Jugore dhe Mitrovica Veriore e sotme), tashmë duhet të hartohen PZHK të reja përkatëse që janë në përputhje me ligjin e ri (nr. 04/L-174) për çdo komunë veçmas. Në këtë mënyrë, të dyja komunat kanë filluar procesin e hartimit të PZHK-ve të tyre të reja.

## Qëllimi i vlerësimit

Qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë vlerësimi i zbatimit të PZHK-së 2009-2025+ (PZHU-së dhe PRrU-ve përcjellëse) për Komunën e Mitrovicës në praktikë, përputhshmërinë e dokumenteve të planifikimit dhe përputhshmërinë e tyre me Ligjin e ri për Planifikim Hapësinor (nr. 04/L-174) në Kosovë. Të gjeturat/Produktet e këtij procesi do të shërbejnë si bazë dhe mësim të marra për hartimin e PZHK-së dhe HZK-së re për Mitrovicën Jugore.

Metodologjia për Vlerësimin e dokumenteve ekzistuese të planifikimit:

1. Përputhshmëria ligjore (kërkesat ligjore)
2. Përputhshmëria në mes të dokumenteve të planifikimit (nga PZHK-ja në PZHU në PRrU)
3. Vlerësimi i zbatimit (Investimet publike dhe private)

Gjetjet (të dhënat ekzistuese) do të shërbejnë në procesin e grumbullimit të të dhënave që mungojnë për hartimin e PZHK-së së re (bazuar në Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor (Nr. 04/L-174) dhe do të strukturohen dhe migrohen në databazën e planifikimit hapësinor komunal.<sup>3</sup> Për më tepër, i tërë procesi i vlerësimit të PZHK-së, mjetet e vlerësimit dhe ky raport i hollësishëm do të shërbejnë si udhëzues për vlerësimin e dokumenteve të planifikimit (PZHK-ve) në komunat tjera në Kosovë.

<sup>1</sup> ASK. 2017. Popullsia e vlerësuar në Kosovë për vitin 2017.

<sup>2</sup> MAPL. 2017. Profili i komunave të Republikës së Kosovës.

<sup>3</sup> Kjo databazë është sugjeruar nga UN-Habitat si komponente shtesë e Aplikacionit të Planifikimit Hapësinor në Kosovë (SPAK/APHK), i cili përmban vetëm propozimet/sugjerimet e PZHK-ve dhe HZK-ve.



## Procesi dhe mjetet e vlerësimit

Mjetet e Vlerësimit të PZHK-së janë prezantuar në Punëtorinë Programatike në fund të Fazës Fillestare (Vlerësimi Bazë) në të cilën Vlerësimi i PZHK-së është përcaktuar nga EKP si një nga prioritetet kryesore në fazën kyce të zbatimit të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës. Përgatitjet për procesin e vlerësimit të PZHK-së filluan me një punëtori fillestare të organizuar për përfaqësuesit e Komunës së Mitrovicës Jugore dhe Komunës së Mitrovicës Veriore me mbështetje të MMPH dhe MAPL, në Manastir/Bitola, Maqedoni. Kjo punëtori ka pasur për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe adresimin e çështjeve të ndërlidhura me planifikimin, siç është Vlerësimi i PZHK-së/Korniza Ligjore e Planifikimit, Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban dhe Baza e të Dhënave Hapësinore. Përveç shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy komunave, kjo punëtori gjithashtu ka shërbyer për prezantimin e mjeteve të vlerësimit për komunën dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe për testimin e këtyre mjeteve.



Foto 1. Pjesëmarrësit e punëtorisë për vlerësimin e PZHK-së, Manastir, korrik 2018.

Për Mitrovicën Jugore procesi i vlerësimit të PZHK është bërë nga EKP dhe kontribuues tjerë substancial, me ndihmën dhe udhëzimin e UN-Habitat dhe mbështetur nga MMPH. Grupet ishin përgjegjëse për analizimin e të dhënave të ofruara në PZHK-në ekzistuese sipas mjeteve të vlerësimit si dhe për përditësimin dhe plotësimin e të dhënave të identifikuara si të vjetërsuara dhe që mungojnë, të cilat kërkohen me ligj (nr. 04/L-174) për hartimin e PZHK të re.

Drejtoritë e përfshira në kuadër të Mitrovicës Jugore përfshijnë:

- Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm
- Drejtoria për Mbrojtje Mjedisore
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Drejtoria e Inspektimit
- Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Shëndetësisë
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit
- Drejtoria e Administratës

Për qëllim të procesit të vlerësimit, përfaqësuesit e komunës dhe shoqërisë civile janë ndarë në katër grupe. Këto grupe ishin të përziera, me përbërje nga zyrtarët komunal nga drejtori të ndryshme dhe kanë adresuar katër tema (një temë për grup):

1. Pajtueshmëria me kornizën ligjore për planifikim hapësinor
2. Zbatimi i PZHK/PZHU dhe PRRU-ve
3. Projektet kapitale
4. Projektet private

Mjetet e vlerësimit për vlerësimin e PZHK-së të Mitrovicës janë përgatitur nga UN-Habitat, të cilat janë ndarë në tri kategori:

1. Pajtueshmëria me kornizën ligjore për planifikim hapësinor
  - a. Të dhënat komunale
  - b. Struktura e pjesës tekstuale të PZHK dhe PZHU
  - c. Lista dhe përmbajtja e pjesës hartografike të PZHK dhe PZHU
2. Pajtueshmëria/Zbatimi i PZHK dhe PZHU
  - a. Pajtueshmëria e pjesës tekstuale të PZHK/PZHU me Planet Rregulluese Urbane (PRRU-të)
  - b. Pajtueshmëria e pjesës hartografike (dizajnit urban) të PZHK/PZHU me Planet Rregulluese Urbane (PRRU-të)
  - c. Pajtueshmëria e projekteve kapitale dhe aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve me PZHK/PZHU
  - d. Pajtueshmëria e investimeve private (aktivitetet e banimit dhe ekonomike) me PZHK/PZHU
3. Vlerësimi i qëndrueshmërisë
  - a. Vlerësimi i qëndrueshmërisë sociale
  - b. Vlerësimi i qëndrueshmërisë ekonomike
  - c. Vlerësimi i qëndrueshmërisë mjedisore
  - d. Qeverisja

Ky raport paraqet të gjeturat nga katër grupe tematike sa i përket dy mjeteve të para të vlerësimit, pasi që mjeti i tretë i vlerësimit është akoma në proces të hartimit.

# **1. PAJTUESHMËRIA ME KORNIZËN LIGJORE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**



## 1. Pajtueshmëria me kornizën ligjore të planifikimit hapësinor

Mjeti i parë i vlerësimit vlerëson pajtueshmërinë e PZHK-së me kornizën ligjore për planifikim hapësinor nëpërmjet të dhënave komunale të ofruara, strukturës së saj (tabelës së përmbajtjes) të pjesës tekstuale dhe listës dhe përmbajtjes së pjesë hartografike. Dokumentet e referuara përfshijnë Ligjin për Planifikim Hapësinor (nr. 04/L-174) dhe Udhëzimin e tij Administrativ mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal (nr. 11/2015). Anipse kjo PZHK është hartuar me ligjin e vjetër, vlerësimi është bërë me ligjin e ri në mënyrë që tableat për të dhënat, burimet e informacionit etj. të shërbejnë për hartimin e PZHK-së së re.

### 1.1. Të dhënat komunale

Modeli i parë i mjetit të parë të vlerësimit vlerëson ofrimin e të dhënave komunale në PZHK sipas 13 fushave specifike tematike, si dhe vitin e të dhënave në dispozicion, hapat në vijim që duhet të ndërmerren nëse të dhënat mungojnë apo nuk janë të plota (d.m.th. përditësimet apo plotësimet) dhe burimi i informacionit ku mund të merren të dhënat për përdorim në të ardhmen nëse mungojnë në PZHK.

Fushat tematike përfshijnë:

1. Trashëgiminë kulturore dhe natyrore,
2. Demografinë,
3. Vendbanimet,
4. Banimin,
5. Vendbanimet joformale,
6. Infrastrukturën sociale dhe shërbimet sociale,
7. Ekonominë,
8. Infrastrukturën teknike dhe shërbimet,
9. Infrastrukturën e transportit dhe shërbimet,
10. Fatkeqësitë natyrore,
11. Ndotjen mjedisore,
12. Shfrytëzimin dhe transformimin e tokës, dhe
13. Kapacitetet administrative dhe financiare.<sup>4</sup>


Siç është vlerësuar, ofrimi i përgjithshëm i të dhënave në kuadër të PZHK të Mitrovicës është 6.5%, që do të thotë se nga 1,295 fushat specifike të kërkuara në Modelin e Vlerësimit 1.a (Shtojca 1) vetëm 84 fusha janë ofruar përderisa mungojnë 93.5% (Grafiku 1). Lloji i informacionit që është ofruar më së shumti përfshinë emrin (d.m.th. emrin e monumenteve arkitekturore, institucioneve arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportive), lokacionin (zakonisht vetëm të identifikuar vizualisht në harta), zonat (d.m.th. ndërtesat e shkollave fillore, trupat ujore, tokën bujqësore dhe pyjore) dhe disa të dhënat tjera specifike (d.m.th. gjatësinë e rrugës, linjat dhe ndalesat e autobusit, numri i ndërmarrjeve ekonomike, numri i të punësuarve, llojet e ndotësve të ujit dhe tokës etj.).

Nga 84 fushat e ofruara, 52 (61.9%) janë në dispozicion dhe 32 (38.1%) janë pjesërisht në dispozicion (Grafiku 2).


---

<sup>4</sup> Këto fusha tematike kërkojnë me Udhëzimin Administrativ nr. 11/2015, por janë ridizajnuar për qëllim të ushtrimit të vlerësimit të PZHK për Mitrovicën. Informacionet e marra në tabela do të përdoren edhe në bazën e integruar komunale të të dhënave.

**Grafiku 1: Ofrimi i përgjithshëm i të dhënave**




**Grafiku 2: Niveli i disponueshmërisë së të dhënave**



Përmes këtij vlerësimi, vërehet se fushat tematike më të mbuluara në PZHK-në e Mitrovicës përfshijnë ndotjen mjedisore (5 fusha të mbuluara nga 12 në total = 41.7%), ekonominë (27/184 = 14.7%) dhe përdorimi dhe transformimi i tokës (7/57 = 12.3%). Ndërsa fushat tematike që nuk sigurojnë të dhëna specifike të kërkuara në mjetin e vlerësimit përfshijnë Demografinë, Vendbanimet, Vendbanimet joformale, Banimin, si dhe Fatkeqësitë Natyrore.

**Grafiku 3: Disponueshmëria e të dhënave sipas fushave tematike (%)**



Sa i përket vitit të të dhënave në kuadër të PZHK-së, shumica e të dhënave janë nga periudha e viteve 2004-2007, ndërsa 28 fushat e mbetura (33.33%) e të dhënave të ofruara, nuk i referohen fare asnjë viti. Pasi që PZHK-ja e Mitrovicës adreson tërë komunën e Mitrovicës (para se të ndahej zyrtarisht në Mitrovicën Jugore dhe Veriore), dhe u publikua në vitin 2009 (pothuajse 10 vjet më parë), shumica e të dhënave në dispozicion dhe atyre pjesërisht të disponueshme, duhet të azhurnohen gjatë hartimit të PZHK-së së re për Mitrovicën Jugore.

Sa i përket burimit të informacionit, ku mund të gjenden të dhënat që mungojnë për secilën fushë tematike, ju lutemi shihni më poshtë Matricën- Listën e Institucioneve (informatat e hollësishme jepen në Shtojcën 2).

Institucionet Relevante		1. Trashëgimia kulturore dhe natyrore	2. Demografia	3. vendbanimet	4. Vendbanimet joformale	5. Banimi	6. Infrastruktura, shërbimet sociale dhe publike	6.1. Institucionet shëndetësore	6.2. Institucionet arsimore	6.3. Institucionet kulturore dhe rinore	6.4. Institucionet e sportit dhe rekreacionit	6.5. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit	6.6. Institucionet fetare	6.7. Institucionet administrative	6.8. Hapësirat publike	7. Ekonomia	8. Infrastruktura dhe shërbimet teknike	9. Onfrastruktura dhe shërbimet e transportit	10. Fatkeqësitë natyrore	11. ndotja e mjedisit	12. Shfrytëzimi i tokës dhe transformimi i tokës	13. Kapacitetet administrative dhe financiare			
Institucionet Qendrore	MBPZHR																								
	KFA																								
	ASK																								
	IAK																								
	IMM																								
	KEDS																								
	KUR																								
	MF																								
	MI																								
	MKRS																								
	MMPH																								
	MPMS																								
	MZHE																								
	PK																								
	Trainkos																								
Institucionet lokale	BIM																								
	DA																								
	DAP																								
	DBZHR																								
	DFZHE																								
	DGJKP																								
	DIEMS																								
	DKRS																								
	DMM																								
	DMSH																								
	DPU																								
	DSH																								
	DSHPI																								
	ISHP																								
	HANDIKOS																								
	QKMF																								
	QPS																								
	SR																								
	ZP																								


Tabela 2: Lista e institucioneve për të dhënat që mungojnë (ju lutem referohuni listës së akronimeve)

### 1.1.1. Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Sektori i trashëgimisë kulturore dhe natyrore mbledh informata lidhur me trashëgiminë arkitektonike, trashëgiminë arkeologjike, peizazhet kulturore, zonat e veçanta të mbrojtura, rezervat natyrore, parqet kombëtare, zonat natyrore të mbrojtura, parqet natyrore, monumentet natyrore, peizazhet e mbrojtura dhe monumente arkitekturore të parqeve. Secila kategori vlerëson informacionin e dhënë lidhur me (regjistrimin) numrin, emrin, zonën, vendndodhjen dhe statusin ligjor.

Nga këto 11 kategori, PZHK përfshinë informata më të detajuara rreth trashëgimisë arkitektonike (26.66%), pasuar nga rezervat natyrore (20%), monumentet natyrore (20%) dhe trashëgimia arkeologjike (5%).<sup>5</sup> Në kuadër të trashëgimisë arkitektonike, ofrohet informacioni vetëm rreth monumenteve arkitektonike, duke përfshirë emrin e monumentit, vendndodhjen (qytetin apo fshatrat e Mitrovicës), statusin ligjor (d.m.th. inventarizuara apo mbrojtur) dhe numrin e regjistrimit (80% e informacionit të kërkuar).<sup>6</sup> Sidoqoftë, nuk ofrohet asnjë informacion lidhur me fushat e tyre përkatëse dhe vitin e të dhënave të siguruara në PZHK. Trashëgimia arkeologjike (vendbanimet arkeologjike) dhe trashëgimia natyrore (pemët e vjetra dhe burimet e ujit) vetëm janë identifikuar në mënyrë vizuale në një hartë të përbashkët, prandaj është dhënë vetëm lokacioni i tyre.<sup>7</sup>

**Grafiku 4: Disponueshmëria e të dhënave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore (%)**



**Tabela 3. Disponueshmëria e të dhënave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**

Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruara	Përqindja (%)
Trashëgimia arkitekturore	Pjesërisht të disponueshme	Numri, emri, zona, lokacioni dhe statusi ligjor (5/15)	33
Trashëgimia arkeologjike	Pjesërisht të disponueshme	Lokacioni i vendbanimeve arkeologjike (të hartëzuara) (1/20)	5
Peizazhe kulturore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Zonat e veçanta të	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0

<sup>5</sup> Grupi i parë i punues për vlerësimin e PZHK-së ka identifikuar 87 monumente arkitekturore në Mitrovicën e Jugut, të përmendura në PZHK-në, mes tyre xhamitë, kishat, teqet, shtëpitë e varrit (tyrbe), hamamet (banjat e vjetra turke), kullat (një muze, dy hotele dhe një zyrë postare).

<sup>6</sup> PZHK Mitrovicë, 2009, 84-86

<sup>7</sup> PZHK Mitrovicë, 2009, 87

mbrojtura			
Rezervat natyrore	Nuk janë në dispozicion	Vendndodhja e burimeve ujore (të hartëzuara) (1/5)	20
Parqet kombëtare	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Zonat e veçanta të mbrojtura natyrore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Parqet natyrore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Monumente natyrore	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja e pemëve të vjetra (harta) (1/5)	20
Peizazhe të mbrojtura	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Monumente arkitekturore të parqeve	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
<b>Totali (7/80)</b>			<b>8.75</b>

### 1.1.2 Demografia

Sektori i demografisë mbledh informacione lidhur me sfondin demografik të popullsisë (gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, ekonomitë familjare, norma e lindjeve dhe vdekshmërisë sipas vendbanimeve), shkalla e migracionit (i brendshëm dhe ndërkombëtar), niveli i arsimit dhe statusi socio-ekonomik. Përveç numrit të përgjithshëm të popullsisë, i cili është gjithashtu një vlerësim (meqenëse PZHK-ja është hartuar para regjistrimit të popullsisë në Kosovë në vitin 2011), nuk ofrohet asnjë informacion tjetër lidhur me kategoritë specifike të kërkuara. Prandaj, asnjë nga 20 fushat e kërkuara nuk janë siguruar.

### 1.1.3 Vendbanimet

PZHK-ja aktuale nuk ofron një listë të posaçme të emrave, tipologjisë, popullsisë, zonës dhe densitetit të vendbanimeve (lagjeve urbane dhe fshatrave). Prandaj, nuk është siguruar asnjë nga 6 fushat e kërkuara.

### 1.1.4 Vendbanimet joformale

Sa u përket vendbanimeve joformale, në Mitrovicë janë tre vendbanime të identifikuar joformale, dy prej të cilave ndodhen në Mitrovicën e Jugut dhe një në Mitrovicën e Veriut<sup>8</sup>. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion në lidhje me tipologjinë e tyre (urbane apo rurale), pronësinë e pronës (publike ose private), numrin e banorëve, numrin e shtëpive me një familje, qasjen në infrastrukturën rrugore dhe teknike dhe shërbimet publike dhe instrumentet rregullative. Prandaj, nuk është e disponueshme asnjë nga 6 fushat e kërkuara.

### 1.1.5 Banimi

Për më tepër, PZHK-së i mungojnë informatat për sektorin e banimit, përfshirë llojet e banimit (p.sh. shtëpi individuale, shtëpi të bashkëngjitura, shtëpi kolektive), numrin e njësive të banimit, pronësinë, karakteristikat e banimit (p.sh. viti/periudha e ndërtimit, sipërfaqja, etazhiteti, numri i dhomave), vende parkimi, qasje në infrastrukturë dhe shërbime, banesa sociale etj. Nga 75 fusha për njësi individuale të banimit dhe 75 të tjera për banim kolektiv, nuk ofrohet asnjë informacion.


### 1.1.6 Infrastruktura sociale dhe shërbimet publike

Sektori i infrastrukturës sociale dhe shërbimeve publike përfshinë informata mbi institucionet e kujdesit shëndetësor, arsimit, kulturës dhe rinisë, sportit, rekreacionit, mirëqenies sociale,

<sup>8</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 95-96

institucionet fetare dhe administrative si dhe hapësirat publike (siç janë varrezat, sheshet dhe parqet). Grupi i parë punues ka identifikuar informata në lidhje me institucionet shëndetësore, arsimore dhe ato sportive dhe rekreative në PZHK të Mitrovicës. Nga 337 fusha specifike të kërkuara në këtë sektor, janë ofruar vetëm 29 (8.6%).

**Grafiku 5: Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës sociale dhe shërbimeve publike (%)**



#### 1.1.6.1 Institucionet shëndetësore

Tabela e vlerësimit të PZHK-së kategorizon institucionet shëndetësore në institucione primare dhe ato dytësore. Në Mitrovicën e Jugut janë 18 institucione të kujdesit parësor shëndetësor. Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor përfshijnë një Qendër Kryesore të Shëndetit Familjar, shtatë Qendra Shëndetësore Familjare dhe dhjetë Ambulanca të Shëndetit Familjar. Tetë (44.44%) nga 18 institucionet shëndetësore janë të vendosura brenda zonës urbane<sup>9</sup>. Informacioni i ofruar për institucionet shëndetësore në PZHK të Mitrovicës është i disponueshëm vetëm në aspektin e vendndodhjes së tyre në harta<sup>10</sup>. Asnjë informacion nuk ofrohet lidhur me vitin e themelimit të institucioneve, sipërfaqen e ndërtuar dhe etazhitetin, vendet e parkimit për punëtorët dhe vizitorët, zonën e gjelbëruar, numrin e mjekëve dhe numrin e popullsisë së shërbyer.

Instituti i Shëndetit Publik gjendet edhe në Mitrovicën e Jugut, ndërsa në Mitrovicën Veriore është identifikuar edhe një institucion i kujdesit shëndetësor dytësor.<sup>11</sup>

**Tabela 4. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve shëndetësore**

Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruar	Përqindja (%)
Kujdesi parësor shëndetësor	Pjesërisht të disponueshme	Emri dhe vendndodhja (të hartëzuara në mënyrë vizuale) (2/21))	9.5
Kujdes dytësor shëndetësor	Pjesërisht të disponueshme	Emri dhe vendndodhja (të hartëzuara në mënyrë vizuale) (2/23)	8.7
<b>Totali (4/44)</b>			<b>9.10</b>

<sup>9</sup> Zona urbane e përkufizuar në PZHU të Mitrovicës (2009) përbëhet nga lagjet urbane "Qendra", Suhadolli (Zona e Biznesit, Zona Industriale, Sitnica, Bair, Ura e Gjakut, Vaganicë, Fidanishte, Ilirida, Zhabar i Poshtëm, Zhabar i Epërm, Shipol dhe Shupkovc.

<sup>10</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 76-78

<sup>11</sup> Në kohën e hartimit të PZHK-së së Mitrovicës, shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor ofroheshin në Spitalin e Përgjithshëm të vendosur në pjesën veriore të qytetit (Mitrovica e Veriut). Sidoqoftë, që nga viti 2013, Mitrovica e Jugut është shërbyer nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri", i cili është pjesë e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në Prishtinë.

### 1.1.6.2 Institucionet arsimore

Institucionet arsimore të identifikuar në Mitrovicën Jugore përfshijnë një institucion parashkollor publik, 26 shkolla fillore (duke përfshirë dy shkolla speciale), tre shkolla të mesme dhe dy fakultete. Nga këto 32 institucione, 18 (56.25%) janë të vendosur në zonën urbane (përfshirë institucionin parashkollor, të gjitha shkollat e mesme dhe fakultetet), ndërsa pjesa tjetër e këtyre institucioneve janë në fshatra. Informacioni i përbashkët i ofruar në kuadër të PZHK-së për të gjitha kategoritë arsimore përfshinë emrin e institucionit arsimor, vendndodhjen, zonën gravitacionale (të hartëzuar) si dhe vitin e të dhënave të ofruara. Për shkollat fillore janë shtuar informacione për zonën ku është ndërtuar dhe numrin e klasave. Megjithatë, nuk ofrohen informacione lidhur me vitin e themelimit, karakteristikat e ndërtesave (numri i kateve, ndërtesat e tjera mbështetëse, hapësirat e parkimit), numri i popullatës së shërbyer, numri i nxënësve/studentëve të regjistruar femra dhe meshkuj për një vendndodhje, numri i të diplomuarve dhe studentët që kanë braktisur shkollimin, si dhe numrin e mësimdhënësve.

Tabela 5. Disponueshmëria e të dhënave të institucioneve arsimore			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e ofruara	Përqindja (%)
Institucionet parashkollore	Pjesërisht të disponueshme	Emri, vendndodhja dhe zona gravitacionale (të hartëzuara) (3/26)	11.5
Shkollat fillore	Pjesërisht të disponueshme	Emri, vendndodhja dhe zona gravitacionale (të hartëzuara), zona e ndërtuar, numri i klasave (5/26))	19.2
Shkollat e mesme	Pjesërisht të disponueshme	Emri, vendndodhja dhe zona gravitacionale (të hartëzuara) (3/26)	11.5
Universitetet	Pjesërisht të disponueshme	Emri, vendndodhja dhe zona gravitacionale (të hartëzuara) (3/26)	11.5
<b>Totali (14/104)</b>			13.46

### 1.1.6.2 Sporti dhe rekreacioni

Sa i përket sportit dhe rekreacionit, grupi i parë i punues ka identifikuar tre objekte profesionale sportive, në mesin e tyre stadiumin e vjetër të futbollit, stadiumin e ri olimpik të futbollit dhe sallën sportive "Minatori". Të gjitha këto objekte ndodhen brenda zonës urbane<sup>12</sup>. Përveç emrave dhe vendndodhjeve të këtyre objekteve sportive, asnjë informacion tjetër (p.sh. zona e objekteve, viti i ndërtimit, popullsia e shërbyer, numri i zyrtarëve, sipërfaqja e ndërtuar, hapësirat e parkimit dhe hapësirat e gjelbra), nuk ofrohet në kuadër të PZHK-së së Mitrovicës.

Tabela 6. Disponueshmëria e të dhënave së institucioneve të sportit dhe rekreacionit			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e ofruara	Përqindja (%)
Sportet profesionale	Pjesërisht të disponueshme	Emri dhe vendndodhja (vizualisht të hartëzuara) (2/22)	9.1
Sportet rekreative	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/11)	0
<b>Totali (2/33)</b>			6.06

<sup>12</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 137-138



#### 1.1.6.4 Institucionet kulturore, fetare dhe administrative

PZHK-ja e Mitrovicës ofron informata të pakta rreth Qendrës së Kulturës (dhe disa ngjarjeve kulturore/festivale), bibliotekës publike dhe ndërtesave fetare (xhamive dhe kishave), si dhe vendeve të tyre.<sup>13</sup>

Tabela 7. Disponueshmëria e të dhënave për institucionet kulturore dhe fetare			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e ofruara	Përqindja (%)
Institucionet kulturore	Pjesërisht të disponueshme	Emri dhe vendndodhja (të hartëzuara në mënyrë vizuale) (2/22)	9.1
Institucionet fetare	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja (e hartëzuar në mënyrë vizuale) (1/16)	6.25
Institucionet administrative	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/20)	0

#### 1.1.6.5 Institucionet e mirëqenies sociale

Institucionet e identifikuara të mirëqenies sociale dhe komunitetit në Mitrovicën e Jugut përfshijnë Qendrën për Mirëqenie Sociale dhe një strehimore për viktimat e dhunës në familje<sup>14</sup>. Informatat e ofruara për Qendrën e Mirëqenies Sociale përfshijnë emrin, vitin e krijimit dhe vendndodhjen (paraqitur në hartë).

Tabela 8. Disponueshmëria e të dhënave për institucionet e mirëqenies			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruar	Përqindja (%)
Kujdesi social për njerëzit në nevojë	Pjesërisht të disponueshme	Emri, viti i themelimit dhe vendndodhja (të hartëzuara në mënyrë vizuale) (3/19)	15.80
Njerëzit në nevojë/kategori	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/13)	0
Institucionet e kujdesit social për njerëzit me nevoja të veçanta	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/19)	0
Institucionet e shërbimeve komunitare	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/18)	0
<b>Totali (3/69)</b>			<b>4.30</b>

#### 1.1.6.6 Hapësirat publike

PZHK-ja përfshinë disa informacione lidhur me hapësirat e hapura dhe të gjelbra përgjatë lumit Ibër, Sitnica dhe Lushta, parkun e qytetit, një vendkalim këmbësorësh në Rrugën "Agim Hajrizi", dy sheshe të vogla (Mehë Uka dhe Adem Jashari)<sup>15</sup> si dhe varrezat<sup>16</sup>. Disa nga këto karakteristika paraqiten në mënyrë vizuale në hartë, por nuk ofrohet asnjë informacion për vitin e ndërtimit, sipërfaqen e tyre të gjelbëruar dhe të përgjithshme, hapësirat e parkimit dhe numrin e njerëzve që i përdorin ato.

Tabela 9. Disponueshmëria e të dhënave për hapësirat publike			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruar	Përqindja (%)
Varrezat	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja (1/13)	7.7

<sup>13</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 79

<sup>14</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 79

<sup>15</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 136-138

<sup>16</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 81

Sheshet	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja (1/8)	12.5
Parqet	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja (1/8)	12.5
<b>Totali (3/29)</b>			<b>10.34</b>

### 1.1.7 Ekonomia

Sektori i ekonomisë përfshinë informacione për BPV-në, ndërmarrjet ekonomike (në përgjithësi), zonat ekonomike (p.sh. parqet/zonat industriale, inkubatorët e biznesit/parqet, parqet teknologjike, zonat e lira dhe punonjësit e tyre), ndërmarrjet ekonomike sektoriale ((p.sh. bujqësi, pylltari, peshkim, miniera, gurore, prodhimtari, shërbime, ndërtimtari, tregti, transportim, akomodim dhe ushqimi, informim dhe komunikim, financim dhe sigurim, pasuritë e paluajtshme, shkencore dhe ato profesionale etj.), zonat tregtare, zonat turistike, ndërmarrjet bujqësore dhe trendët e rendimentit të prodhimit (të gjitha për katër vitet e fundit). Tabela 9 tregon të dhënat e identifikuara në sektorin e ekonomisë në kuadër të PZHK-së së Mitrovicës, në mesin e të cilave të dhënat më të disponueshme përfshijnë numrin e ndërmarrjeve (private, publike dhe në total), numrin e personave të punësuar në disa prej këtyre ndërmarrjeve, zona e parqeve industriale, tokat bujqësore, livadhet dhe kullotat<sup>17</sup>. Përqindja e të dhënave të ofruara në këtë fushë është 14.7%.

**Grafiku 6: Disponueshmëria e të dhënave ekonomike (%)**




Tabela 10. Disponueshmëria e të dhënave të ekonomisë			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruara	Përqindja (%)
BPV	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/4)	0
Ndërmarrjet ekonomike	Pjesërisht të disponueshme	Nr. i ndërmarrjeve të përgjithshme private dhe publike, nr. i personave të punësuar në sektorin privat dhe publik (6/14)	42.9
Zonat ekonomike	Pjesërisht të disponueshme	Zona e parqeve industriale (1/12)	8.3
Ndërmarrjet sektoriale ekonomike	Pjesërisht të disponueshme	Nr. i ndërmarrjeve ekonomike (13/84)	15.5
Zonat tregtare	Pjesërisht të disponueshme	Vendndodhja (në hartë) (1/9)	11.1
Zonat turistike	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/9)	0
Ndërmarrjet bujqësore	Pjesërisht të disponueshme	Nr. i ndërmarrjeve bujqësore, sipërfaqja e tokës bujqësore private dhe publike, sipërfaqja e tokës së kultivuar dhe asaj jo të kultivuar, sipërfaqja e livadheve dhe kullotave (6/18)	33.3


<sup>17</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 54-64

Trendët e prodhimit të rendimentit	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/34)	0
<b>Totali (27/184)</b>			<b>14.7</b>

### 1.1.8 Infrastruktura dhe shërbimet teknike

Kjo pjesë mbledh informacione lidhur me infrastrukturën e furnizimit me ujë (kapacitetet e burimeve tokësore dhe nëntokësore të ujit, kapacitetet për shfrytëzimin e ujit, rrjetin e ujësjellësit, kapacitetin e trajtimit të ujit, kapacitetin e furnizimit dhe ruajtjes së ujit për vendbanim, vjetërsinë e rezervuarëve, numrin e ekonomive familjare për vendbanim, numrin e përdoruesve publik dhe komercialë për vendbanim dhe çmimet për amvisëritë, përdoruesit publikë dhe komercialë), rrjetin e kanalizimit (numri i njësive të shërbyera për operator dhe vendbanim), dhe rrjeti primar dhe sekondar të ujësjellësit (dimensionet dhe vjetërsia e tubave për lokacion). PZHK-ja e Mitrovicës ofron informata të kufizuara sa i përket infrastrukturës së furnizimit me ujë siç tregohet në Tabelën 10. Meqenëse rrjeti i ujësjellësit është në nivel rajonal, nuk janë ofruar të dhënat në nivel të vendbanimeve.

**Grafiku 7: Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës teknike (%)**



**Tabela 11. Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës teknike**


Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Të dhënat e siguruara	Përqindja (%)
Infrastruktura e furnizimit me ujë	Pjesërisht të disponueshme	Rrjeti total i ujit, kapaciteti i trajtimit të ujit (2/21)	9.52
Rrjeti i kanalizimit	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/4)	0
Rrjeti primar i furnizimit me ujë	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/11)	0
Rrjeti sekondar i furnizimit me ujë	Nuk janë të disponueshme	Asnjë (0/11)	0
<b>Totali (2/47)</b>			<b>4.25</b>

### 1.1.9 Infrastruktura dhe shërbimet e transportit

Seksioni për infrastrukturën dhe shërbimet e transportit mbledh informata në lidhje me auto-udhët, rrugët nacionale, rrugët regionale dhe rrugët lokale, si dhe karakteristikat e tyre fizike dhe hapësinore (gjerësia dhe gjatësia e rrugëve, sipërfaqja e asfaltuar dhe materialet, vend parkimet, vendndalimet për autobusë, vendndalimet për taksit, objektet për menaxhimin e komunikacionit, pikat furnizuese me karburant, objektet e mirëmbajtjes së automjeteve etj.), rrugët brenda vendbanimeve (shpejtësia maksimale, intensiteti, ngarkesa, gjerësia e korsive, gjerësia e shtigjeve të këmbësorëve dhe çiklizmit, si dhe gjerësia dhe gjatësia e urave dhe e tuneleve etj.), rrugët kryesore urbane, rrugët dytësore urbane, rrugët lidhëse, rrugët e pa-kategorizuara dhe transporti publik

rrugor (terminali i autobusëve, linjat e autobusëve dhe vendndalimet e tij, stacionet e taksive, parkingjet, numri i pasagjerëve, etj.). Gjatë hartimit të PZHK-së së Mitrovicës, nuk ekzistonte asnjë bazë të dhënash / kadastër i rrjetit të rrugëve. Prandaj, shumica e të dhënave për kategori të veçanta të rrugëve nuk janë ofruar në kuadër të PZHK.

**Grafiku 8: Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës së transportit (%)**



**Tabela 12. Disponueshmëria e të dhënave të infrastrukturës së transportit**

Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Informatat e siguruara	Përqindja (%)
Autoudhët, rrugët nacionale, rrugët regjionale dhe lokale, si dhe karakteristikat e tyre fizike dhe hapësinore	Pjesërisht në dispozicion	Nr. i stacioneve të autobusëve në rrugët lokale (1/41)	2.44
Vendbanimet	Pjesërisht në dispozicion	Gjatësia e rrugës (1/44)	2.27
Rrugët kryesore urbane	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/44)	0
Rrugët dytësore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/44)	0
Rrugët lidhëse	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/44)	0
Rrugët e pakategorizuara	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/44)	0
Transporti publik rrugor	Pjesërisht në dispozicion	Terminalët e autobusëve dhe linjat ndër-urbane, linjat nacionale, stacionet e autobusëve, linja periferike (4/37)	10.81
<b>Totali (6/298)</b>			<b>2.01</b>


#### 1.1.10 Fatkeqësitë natyrore

Seksioni i fatkeqësive natyrore ofron informata rreth zonës së prekur nga kategoritë kryesore të fatkeqësive natyrore (erozioni, tërmetet, përmytjet, rrëshqitjet e tokës dhe zjarret pyjore) në nivel komunal dhe kombëtar. Nga 20 kategoritë e kërkuara në këtë seksion, asnjë nuk është siguruar në PZHK.

#### 1.1.11 Ndotja mjedisore

Ky seksion mbledh të dhëna lidhur me ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe ndotjen akustike (ndotësit dhe zonat e prekura) në vendet e matura. Të dhënat e siguruara në PZHK përbëhen kryesisht nga ndotësit e ujit, tokës dhe ajrit dhe disa nga zonat e prekura (hartëzuara).

**Grafiku 9: Disponueshmëria e të dhënave të ndotjes së mjedisit (%)**




**Tabela 13. Disponueshmëria e të dhënave të ndotjes së mjedisit**

Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Informatat e siguruar	Përqindja (%)
Ndotësit dhe vendet e matura	Pjesërisht në dispozicion	Ndotësit e ajrit, ujit dhe tokës (3/4)	75
Ndotësit dhe zonat e prekura	Pjesërisht në dispozicion	Ndotësit e ujit dhe tokës dhe zonat e prekura (në hartë) (2/8)	25
<b>Gjithsej (5/12)</b>			<b>41.66</b>

### 1.1.12 Shfrytëzimi dhe transformimi i tokës

Sektori i shfrytëzimit dhe transformimit të tokës mbledh të dhëna për zonën kryesore të kategorive të shfrytëzimit të tokës, duke përfshirë trupat sipërfaqësorë ujorë, sipërfaqen e tokës bujqësore, pyjet, trashëgiminë natyrore, vendet e trashëgimisë kulturore, vendbanimet, vendbanimet joformale, banimet, infrastrukturën sociale dhe publike, zonat ekonomike, infrastrukturën e transportit dhe infrastrukturën teknike. Kategoritë e mbuluara brenda seksionit të shfrytëzimit të tokës në PZHK të Mitrovicës, përfshijnë trupat sipërfaqësorë ujorë, tokën bujqësore, pyjet, vendbanimet, zonën industriale, infrastrukturën rrugore dhe infrastrukturën totale (teknike). Sipërfaqja e tokës bujqësore dhe e vendbanimeve sigurohet në tërësi, ndërsa pjesa tjetër nuk ka informacion specifik.<sup>18</sup>

**Grafiku 10: Shfrytëzimi i tokës dhe disponueshmëria e të dhënave të transformimit (%)**



<sup>18</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 104

Tabela 14. Shfrytëzimi i tokës dhe disponueshmëria e të dhënave të transformimit			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Informatat e siguruar	Përqindja (%)
Trupat sipërfaqësor ujorë	Pjesërisht në dispozicion	Sipërfaqja e përgjithshme e trupave sipërfaqësor ujorë (1/3)	33.33
Toka bujqësore	Në dispozicion	Sipërfaqja e tokës bujqësore (1/1)	100
Pyjet	Pjesërisht në dispozicion	Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve (1/3)	33.33
Trashëgimia natyrore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/8)	0
Vendet e trashëgimisë kulturore	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/5)	0
Vendbanimet	Në dispozicion	Zona e vendbanimeve (1/1)	100
Vendbanimet joformale	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/4)	0
Banimet	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/6)	0
Infrastruktura sociale dhe publike	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/9)	0
Zonat ekonomike	Pjesërisht në dispozicion	Zona industriale (fabrika) (1/5)	20
Zonat tregtare	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/1)	0
Infrastruktura e transportit	Pjesërisht në dispozicion	e infrastrukturës rrugore (1/4)	25
Infrastruktura teknike	Pjesërisht në dispozicion	Sipërfaqja e përgjithshme e infrastrukturës (1/7)	14.3
<b>Gjithsej (7/57)</b>			<b>12.3</b>

#### 1.1.13 Kapacitetet administrative dhe financiare

Ky seksion mbledh informata për kapacitetet administrative dhe financiare të komunës. Kapacitetet administrative përfshijnë numrin e zyrtarëve komunalë, arsimin e tyre formal dhe përvojën e punës. Ndërsa, kapacitetet financiare përfshijnë buxhetin e planifikuar të komunës për katër vitet e ardhshme, buxhetin e shpenzuar (p.sh. pagat, furnizimet dhe shërbimet, subvencionet dhe investimet kapitale), të ardhurat komunale (nga taksat e regjistrimit të pronës dhe të automjeteve, lejet e ndërtimit, aktivitete tregtare etj.) dhe donacionet e pranuar gjatë katër viteve të fundit, si dhe tendencat e shpenzimeve (totali dhe sipas sektorëve). Përveç buxhetit të përgjithshëm të shpenzuar nga komuna, asnjë informacion tjetër i detajuar nuk është siguruar në PZHK të Mitrovicës.<sup>19</sup>

**Grafiku 11: Disponueshmëria e të dhënave të kapaciteteve administrative dhe financiare (%)**




Tabela 15. Disponueshmëria e të dhënave të kapaciteteve administrative dhe financiare			
Kategoria	Disponueshmëria e të dhënave	Informatat e siguruar	Përqindja (%)
Kapacitetet administrative	Nuk janë në dispozicion	Asnjë (0/12)	0
Kapacitetet financiare	Pjesërisht në dispozicion	Gjithsej buxheti i shpenzuar (1/66)	1.5
<b>Gjithsej (1/78)</b>			<b>1.3</b>

<sup>19</sup> PZHK Mitrovica, 2009, 41

## **1.2. Struktura e pjesës tekstuale të PZHK-së**

Modeli i dytë i mjetit të parë të vlerësimit e vlerëson strukturën (tabelën e përmbajtjes) të pjesës tekstuale të PZHK-së nëse përfshinë seksionet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal.

Këto seksione janë:

- Hyrja,
- Profili i Komunës,
- Vlerësimi i Gjendjes,
- Korniza e Planifikimit Hapësinor, dhe
- Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planin e Veprimit.

Ky model vlerësimi duhet të përdoret për vlerësimin e të gjitha PZHK-ve të hartuara pas miratimit të Ligjit të ri për Planifikimin Hapësinor (Nr. 04/L-174) në vitin 2013. Pasi që PZHK-ja e Mitrovicës është hartuar në vitet 2008/2009, nuk mund të vlerësohet nëse zbaton strukturën e kërkuar të lartpërmendur. Edhe pse ky model vlerësimi nuk është i zbatueshëm për këtë dokument specifik të planifikimit hapësinor, struktura e pjesës tekstuale të PZHK-së është vlerësuar prapë se prapë nga grupi punues dhe mund të gjendet në Shtojcën 1. Informatat nga ky vlerësim mund të jenë të dobishme në përcaktimin e seksioneve që mungojnë ose ato që duhet të përditësohen. Meqenëse janë bërë gati 10 vjet që nga hartimi i PZHK-së, është e qartë se shumica e të dhënave të siguruar në PZHK duhet të përditësohen.


## **1.3. Lista dhe përmbajtja e pjesës hartografike të PZHK dhe PZHU**

Modeli i tretë i mjetit të parë të vlerësimit vlerëson listën dhe përmbajtjen e pjesës hartografike të PZHK-së ekzistuese nëse ato përputhen me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2015. Hartat e kërkuara përfshijnë hartën ekzistuese dhe hartën e planifikimit të zhvillimit hapësinor (përfshirë vendbanimet me zonat e ndërtimit dhe masat mbrojtëse), hartën e ardhshme të shfrytëzimit të tokës (p.sh. shfrytëzim bujqësor, banim, afarizëm, teknologjik, industrial dhe shfrytëzim të përzier) dhe planet zhvillimore sektoriale si më poshtë:

- Harta e zhvillimit hapësinor,
- Harta e shfrytëzimit të ardhshëm të tokës,
- Harta e planit të zhvillimit ekonomik,
- Harta e planit të infrastrukturës së transportit,
- Harta e planit urbanistik dhe rural të transportit,
- Harta e planeve e energjisë elektrike dhe termike,
- Harta e ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Harta e sistemit të ujitjes dhe drenazimit,
- Harta e planit të telekomunikacionit dhe atyre të ngjashme të instalimit,
- Harta e planeve të objekteve publike dhe sociale,
- Objektet sportive dhe harta e planifikimit të hapësirave,
- Harta e planit të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra,
- Harta e planit të menaxhimit të varrezave,
- Harta e planit të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore,
- Harta e planit të zbutjes së rrezikut, dhe
- Harta e planit të menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit.



**Grafiku 12: Disponueshmëria e të dhënave në kartografi**



- PZHK-ja e Mitrovicës nuk posedon një Listë të Hartave në fillim të dokumentit. Hartat janë të integruara brenda pjesës tekstuale, kështu ato janë vlerësuar sipas përmbajtjes së tyre (Shtojca 2).

- Nga 16 hartat e lartpërmendura, PZHK-ja e Mitrovicës përfshinë vetëm pesë prej tyre (31.25%), duke përfshirë hartën e zhvillimit hapësinor, hartën e planit të infrastrukturës së transportit, hartën e planeve urbane dhe rurale, hartën e energjisë elektrike dhe termike (pjesërisht) dhe hartën e furnizimit me ujë dhe kanalizimit. Këto harta duhet të përditësohen, ndërsa 11 hartat që mungojnë (68.75%) duhet të hartohen nga fillimi në PZHK-në e re.

## **2. PAJTUESHMËRIA /ZBATIMI I PZHK-së, PZHU-së dhe PRRU-ve**

## 2. Pajtueshmëria/Zbatimi i PZHK-së, PZHU-së dhe PrrU-ve

Modeli i dytë vlerësues e vlerëson pajtueshmërinë e PZHK-së (dhe PZHU-së) me PrrU-të duke vlerësuar nëse kushtet e ndërtimit dhe konceptet hapësinore/zhvillimore të përcaktuara në Planet Rregulluese Urbane të miratuara (PrrU), përputhen me kushtet e zhvillimit të përcaktuara në PZHK dhe PZHU.

### 2.1 Mbulueshmëria e zonës urbane me Plane Rregulluese Urbane (PrrU-të)

Zona urbane e Mitrovicës së Jugut siç përcaktohet në PZHU (2009) përbëhet nga gjithsej 20 lagje. Pas ndarjes së Mitrovicës në dy komuna, gjashtë prej tyre kaluan nën administrimin e Mitrovicës Veriore. Aktualisht, Mitrovica Jugore ka 14 lagje. Nga këto 14 lagje, 6 prej tyre kanë miratuar planet rregulluese:

Plani Rregullues Urban 'Qendra' 2010 - 2025+  
Plani Rregullues Urban 'Fidanishte' 2010 - 2025+  
Plani Rregullues Urban 'Ilirida' 2010 - 2025+  
Plani Rregullues Urban 'Bairi' 2012 - 2025+  
Plani Rregullues Urban 'Ura e Gjakut' 2014  
Plani Rregullues Urban 'Sitnica' 2014

Zona urbane e Mitrovicës Jugore është përafërsisht 1320.93ha (e përcaktuar rishtazi në vendimin për hartimin e PZHK-së së re) prej të cilave 402.09ha mbulohen me plane rregulluese. Ju lutem referojuni hartës 1 për të parë mbulimin e zonave urbane me PrrU-të.

#### 2.1.1 Destinimi i tërësive hapësinore në planet rregulluese në nivel urban - dallimet me PZHU-në

Nga 6 planet rregulluese, përputhshmëria mes PZHU-së dhe PrrU-së lidhur me destinacionin e zonave është e lartë (ju lutem referojuni hartës 2). PrrU "Qendra" në pajtim me PZHU-në parasheh zhvillimin e 7 nëngrupeve të saj me banim shumë familjar - kolektiv dhe individual, administratë publike, afarizëm, gjelbërim, hapësirë publike etj. PrrU 'Fidanishte' është në pajtim me PZHU-në, me përjashtim të nëngrupit F.C (ju lutem referojuni hartës 2), ku megjithëse PZHU parasheh densifikimin dhe kyçjen e zonave të banimit në infrastrukturë, në PrrU, përshkruhet si Hapësirë e Rezervuar (Institucionale-Sportive), banim (tani është ndërtuar lagja për komunitetin RAE), si dhe gjelbërimi përgjatë lumit. PrrU 'Ilirida' është tërësisht në përputhje me PZHU-në. Të dy dokumentet e planifikimit, e shohin zonën si një hapësirë të përshtatshme për banim, banim me afarizëm, institucione dhe parqe. PrrU 'Bairi' është në pajtim me PZHU-në përveç nëngrupeve B.A, B.I, B.L (ju lutem referojuni hartës 2). Përderisa PZHU parashikon nëngrupin B.A si zonë banimi me kyçje në infrastrukturë, në PZHU, zona është plotësuar me përmbajtje shtesë të tilla si shkolla fillore dhe objekte fetare - xhamia. Në anën tjetër, nëngrupet B.I dhe B.L janë përcaktuar në PZHU si zonë e ushtrisë (potencialet për zanate), teksa në PrrU zona B.I është përcaktuar si zonë e shkollës fillore, çerdheve, qendrës së mjekësisë familjare, zanatet dhe zona B.L si sipërfaqe gjelbërimi. Destinacioni i zonave tjera është tërësisht në përputhje. PrrU 'Ura e Gjakut' është plotësisht në pajtim me PZHU-në. Të dy dokumentet e planifikimit e shohin zonën si të përshtatshme për banim kolektiv dhe banim individual, banim me afarizëm, banim me përqindje të lartë të gjelbërimi, institucione dhe parqe. PrrU 'Sitnica' është në pajtim me PZHU-në përveç disa prej nëngrupeve S.F, S.G, S.K (ju lutem referojuni hartës 2). Përderisa PZHU parasheh densifikim dhe kyçjen e zonës së banimit në infrastrukturë, nëngrupi i PrrU-së S.K plotësohet me objekte shoqërore, ndërsa nëngrupi S.G parashikon banim individual, ndërkohë që PZHU parashikon densifikim.





Zona Urbane e Mitrovices: **1320.93 hA**

Grupet urbane me plane rregulluese:

- 1.Qendra: **60.84hA**
- 2.Fidanishte: **63.6hA**
- 3.Illirida: **56.15hA**
- 4.Bair: **94.95hA**
- 5.Ura e gjakut: **89.9hA**
- 6.Sitnica: **36.65hA**

Mbulueshmëria e zones urbane me plane rregulluese: **402.09hA**


Grupet urbane pa plane rregulluese:

- 7.Zona e bizneseve: **~73.50hA**
- 8.Zona Industriale: **~155.55hA**
- 9.Shupkocv: **330hA**
- 10.Vaganicë: **543hA**
- 11.Shipol: **155hA**
- 12.Zhabar i epërm: **264hA**
- 13.Zhabar i poshtëm: **292hA**
- 14.Suhadoll: **127hA**



Mbulueshmëria e zones urbane pa plane rregulluese: **1940hA**

**LEGJENDA**  
Zonat urbane:

- Me plane rregulluese
- Pa plane rregulluese



Zonat urbane të Mitrovices Jugore sipas PZHU-se







**Harta 2: Destinimi i tërësive hapësinore sipas PRrU-ve në nivel urban - dallimet me PZHU-në**

**1. Qendra**

**Q.A** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, administratë dhe shërbime publike, shërbime shëndetësore, afarizëm, hoteleri - restorante, tregëti, shetitore qyteti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore, garazhime nën objekte kolektive, sheshe, hapësira për lojëra të fëmijëve, gjelbërim dekorativ, hapësira të gjelbëruara dhe lulishte, gjelbërim)

**Q.B** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, shërbime publike, afarizëm, tregëti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore nën objekte kolektive, hapësira për lojëra të fëmijëve, gjelbërim)

**Q.C** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, afarizëm, tregëti, hoteleri - restorante dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore nën objekte kolektive, hapësira për lojëra të fëmijëve, hapësira të gjelbëruara, gjelbërim rugor)

**Q.D** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, administratë dhe shërbime publike, afarizëm, hoteleri - restorante, tregëti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore nën objekte, sheshe, hapësira për lojëra të fëmijëve, gjelbërim dekorativ dhe lulishte, gjelbërim i lartë dhe rugor)

**Q.E** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, afarizëm, tregëti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore nën objekte, hapësira për lojëra të fëmijëve, hapësira të gjelbëruara dhe lulishte, gjelbërim rugor)

**Q.F** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, shërbime publike, shërbime arsimi, shërbime fetare, afarizëm, tregëti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nën objekte kolektive, sheshe, hapësira për lojëra të fëmijëve, hapësira të gjelbëruara dhe lulishte, gjelbërim dekorativ)

**Q.G** - Banim shumëfamiljar - kolektiv dhe individual, afarizëm, hoteleri/restorante, tregëti, arsim fillor, arsim i mesëm, edukim për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime fetare dhe funksione përcjellëse (parking, garazhime nëntokësore nën objekte, hapësira për lojëra të fëmijëve, hapësira të gjelbëruara dhe lulishte).

-Zonat e rezervuara  
**Aerali 1** - Zona rekreative sportive  
**Aerali 2** - Zona e bizneseve  
**Aerali 3** - Zona e shëndetësisë  
**Aerali 4** - Zona e gjelbërimit dhe shtratit të lunt  
**Aerali 5** - Zona e bizneseve

**2. Fidanishte**

**F.A** - Banim, Banim dhe Afarizëm , Institucione  
**F.B** - Hapësire e rezervuar (Parku rekreativ-botanik), Hapësire e rezervuar (Institucionale-Universitare)  
**F.C** - Hapësire e rezervuar (Institucionale-Sportive), Banim, Gjelbërim përgjatë lumenjëve (ne PZHU - Dendësimi/kycja ne infrastrukturen e zones se banimit)  
**F.D** - Banim



**3. Ilirida**

**I.A, I.B** - Banim, Banim me afarizëm, Institucione, Afarizëm  
**I.C** - Banim, Banim me afarizëm, Afarizëm, Park  
**I.D** - Banim, Banim me afarizëm, Afarizëm

**4. Bair**


**B.A** - Banim individual, Banim shumëfamiljarë, Shkollë fillore, Religjioz - Xhamia (ne PZHU - zone e banimit e kycur ne infrastrukture)  
**B.B** - Banim individual, Banim shumëfamiljarë, Zanatat, Gjelbërim, sport, rekreacion, institucione publike-sociale  
**B.C, B.D** - Banim individual, Banim shumëfamiljarë  
**B.E** - Banim individual, Sipërfaqe e Lirë Gjelbërimi  
**B.F** - Banim individual, Gjelbërim, sport, rekreacion, Ekonomike - Afarizëm  
**B.G** - Banim individual, Gjelbërim, sport, rekreacion, Sipërfaqe e Lirë Gjelbërimi  
**B.H** - Banim individual, Sipërfaqe e Lirë Gjelbërimi, Zanatat  
**B.I, B.J** - Zanatat  
**B.L** - Shkollë fillore, Qerdhe, QMF, Zanatat (ne PZHU - zone e ushtrise-potencialet per zanate)  
**B.L** - Sipërfaqe e Lirë Gjelbërimi (ne PZHU - zone e ushtrise-potencialet per zanate)

**5. Ura e Gjakut**

**U.A** - Banim kolektiv me afarizëm, banim individual, banim individual me afarizëm, shkolle fillore, ambulanca  
**U.B** - Banim kolektiv me afarizëm, banim individual, banim individual me afarizëm  
**U.C** - Banim kolektiv me afarizëm, banim individual, banim individual me afarizëm, Bl me permbajtje me te larte te gjelbërimit, shkolle fillore, ambulanca

**6. Sitnica**

**S.A** - Banim Kolektiv  
**S.B, S.C, S.F** - Banim Individual  
**S.D** - Gjelbërim i Organizuar  
**S.E** - Banim individual, Varreze e qyteti, Gjelbërim i Organizuar  
**S.K** - Banim individual, Objekte Shoqerore (ne PZHU - zonat e rezervuara- infrastrukture, verifikim per dendësimin e zones se kycur ne infrastrukture  
**S.G** - Banim Individual (ne PZHU - zonat e rezervuara- infrastrukture, verifikim per dendësimin e zones se kycur ne infrastrukture)





### 2.1.2 Pajtueshmëria e pjesës tekstuale dhe hartografike të PZHK/PZHU me Planet Rregulluese Urbane (PRrU)

Ky model i mjetit të dytë, vlerëson pajtueshmërinë e PRrU-ve me PZHK-në dhe PZHU-në në aspekt të zhvillimit dhe kushteve të ndërtimit. Modeli ndahet në pjesën tekstuale dhe atë grafike. Në seksionin tekstual, duhet të jepet shpjegim nëse nuk ka aspak përputhshmëri ose nëse ka pajtueshmëri me vendimet specifike të aprovuara nga kuvendi komunal apo diskutimi publik. Nga ana tjetër, pjesa hartografike analizon grupet dhe nëngrupet brenda PRrU-ve, pajtueshmërinë e tyre me dispozitat e PZHU-së dhe rastet e veçanta të ndikuara nga mospërputhja dhe ndikimi i tyre. Për informacione të mëtutjeshme, janë dhënë tabelat e plotësuar në Shtojcën 2 të këtij raporti.

Harta 3 më poshtë tregon pajtueshmërinë në mes të PZHU-së dhe PRrU-ve, bazuar në kushtet e ndërtimit, ndërsa hartat e mëposhtme 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 japin informacione të detajuara për çdo PRrU. Gjatë kompletimit të tabelave, grupi punues ka identifikuar 4 raste në lidhje me përputhjen / mospërputhjen:

- a. Kushtet e ndërtimit përputhen mes PZHU-së dhe PRrU-së - **me kushte të njëjta** (72.75% të sipërfaqes së mbuluar me PRrU-të);
- b. Kushtet e ndërtimit përputhen mes PZHU-së dhe PRrU-ve - **me vendim të Kuvendit për të rritur koeficientin apo diskutimin publik** (16% të sipërfaqes së mbuluar me PRrU-të);
- c. Kushtet e ndërtimit nuk përputhen mes PZHU-së dhe PRrU-ve - **me kushte të ndryshme** (4.5% të sipërfaqes së mbuluar me PRrU-të);
- d. Kushtet e ndërtimit nuk përputhen mes PZHU-së dhe PRrU-ve - **me kushte të ndryshme** (edhe pas vendimit të Kuvendit për të rritur koeficientin apo diskutim publik) (6.75% të sipërfaqes së mbuluar me PRrU-të);

Plani Rregullues Urban 'Qendra' është 19% në përputhje me PZHU-në me kushte të njëjta; 64% në përputhje me PZHU-në me vendim të kuvendit për të rritur koeficientin dhe 17% nuk përputhet me PZHU-në edhe pas vendimit për ngritjen e koeficientit.


Plani Rregullues Urban 'Fidanishte', 'Ura e Gajkut' dhe 'Sitnica' janë plotësisht në përputhje me PZHU-në.

Plani Rregullues Urban 'Ilirida' është 82% në përputhje me PZHU-në me kushte të njëjta; dhe 18% nuk përputhet me PZHU-në. Plani Rregullues Urban 'Bairi' është 90% në përputhje me PZHU-në me kushte të njëjta; dhe 10% nuk përputhet me PZHU-në edhe pas vendimit për rritjen e koeficientit.

Si rezultat i rritjes së koeficientit me vendim të Kuvendit Komunal për qendrën e qytetit (PRrU "Qendra" dhe një pjesë e PRrU-së "Bairi"), rezultati në terren tregoi një densifikim të zonës përtej pritjeve dhe parashikimeve fillestare. Nëse marrim dy shembuj ilustrues si në Skemën 1, atëherë shohim se efekti i rritjes së koeficientit për 1 linearisht ka ndikuar ndryshe në kushtet e ndërtimit.

Sa për ilustrim kur ndërtesa ishte 2 kate, me koeficient nga 1 në 2, u rrit në 4 kate, apo 100%, kur ndërtesa ishte 8 kate, me koeficient nga 3 në 4, u rrit në 10 kate, apo 25% dhe kështu me radhë.

Ilustrimi skematik 1: Efekti i rritjes së koeficientit për 1






Harta 3: Pajtueshmeria mes PZHK/PZHU me PRrU-të, bazuar në kushtet e ndërtimit - E përgjithshme



**QENDRA**




**LEGJENDA**

- PO
- PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
- JO
- JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)


**FIDANISHTE /SITNICA / URA E GJAKUT**




**ILIRIDA**





**BAIRI**



**GJITHSEJT**



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se








Harta 4: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU " Qendra ' , bazuar në kushtet e ndërtimit

- LEGJENDA**
- PO
  - PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
  - JO
  - JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

**QENDRA**



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se












Harta 5: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Fidanishte', bazuar në kushtet e ndërtimit


LEGJENDA

-  PO
-  PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
-  JO
-  JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

FIDANISHTE



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se








Harta 6: Pajtueshmëria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Ilirida', bazuar në kushtet e ndërtimit


LEGJENDA

- PO
- PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
- JO
- JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

ILIRIDA



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se








Harta 7: Pajtueshmeria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Bair', bazuar në kushtet e ndërtimit



LEGJENDA

- PO
- PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
- JO
- JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

BAIRI



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se












Harta 8: Pajtueshmeria mes PZHk/PZHU dhe PRrU 'Ura e Gjakut', bazuar në kushtet e ndërtimit


LEJENDA

-  PO
-  PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
-  JO
-  JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

URA E GJAKUT



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se








Harta 9: Pajtueshmeria mes PZHK/PZHU dhe PRrU 'Sitnica', bazuar në kushtet e ndërtimit

LEGJENDA

- PO
- PO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)
- JO
- JO (Me vendim të Kuvendit apo diskutim publik)

SITNICA



Zonat urbane te Mitrovices Jugore sipas PZHU-se



## **2.2 Pajtueshmëria ndërmjet PZHK-së/ PZHU-së me Planet Rregulluese Urbane (PRrU-ve) - Dizajni dhe funksioni (konceptet hapësinore)**

### **2.2.1 Përputhshmëria ndërmjet PZHK-së/ PZHU-së me Planet Rregulluese Urbane (PRrU-të) - Rrjeti Rrugor**

Në kuadër të PZHK-së dhe PZHU-së, rrjeti rrugor dhe mobiliteti shihet si një nga fushat prioritare për trajtim në të ardhmen. Përtej rrugëve magjistrale (M2, M22.3) dhe rrugëve nacionale (R111, R129, R200) që paraqesin boshtin kurrizor të sistemit transportues në komunë, propozohet gjithashtu ndërtimi i rrjetit të rrugëve lokale për të bërë lidhjen më të mirë brenda zonës urbane të qytetit por gjithashtu edhe për të lidhur fshatrat e ndryshme të komunës.

Në PZHU trajtohet në nën-kapituj të vecantë infrastruktura rrugore dhe mobiliteti, dhe prioritetet e vendosura janë:

- a. Vazhdimi i rrugës qarkore (Bypass) në jug;
- b. Ndërtimi i rrjetit lokal rrugor;
- c. Vendparkimet në qendër;
- d. Rifunksionalizimi i sistemit të qarkullimit urban të autobusëve;
- e. Përmirësimi i lidhjeve hekurudhore dhe kyçjes së punëtorive të zanateve.

Në këto dokumente të planifikimit, infrastruktura hekurudhore shihet më shumë si kompetencë e nivelit qendror anipse konsiderohet e rëndësishme strategjike pasi që me revitalizimin e rrjetit hekurudhor do të lehtësohej mobiliteti në qytet dhe do të ndikonte direkt në zhvillimin ekonomik të komunës. Si edhe në qytetet e tjera në Kosovë në mënyrë që qyteti të shkarkohet nga trafiku i ngarkuar, propozohet që të ndërtohen vend-parkime të reja në periferi të qytetit dhe arritja në qendër të bëhet përmes transportit publik (nuk ekziston aktualisht në Mitrovicë).

Pas aprovimit të PZHK-së dhe PZHU-së në vitin 2009, komuna e Mitrovicës ka miratuar plane rregulluese urbane për 6 lagje të qytetit, duke filluar me Qendrën, Iliridën dhe Fidanishten në vitin 2010, Bairin në vitin 2012, Sitnicën e Urën e Gjakut në vitin 2014. Në secilën nga këto plane, gjithsesi trajtim i vecantë i është dhënë edhe infrastrukturës rrugore. Harta 10 tregon pajtimet dhe mospajtimet ndërmjet rrjetit rrugor të përcaktuar në PZHU dhe rrjetit rrugor të përcaktuar në PRrU-të përkatëse (si tërësi) kurse harta 11 tregon se si infrastruktura rrugore e paraparë me PRrU-të është zbatuar në terren deri në fillim të vitit 2018.

Në përgjithësi infrastruktura rrugore në PRrU-të e zonës urbane përshtatet në masë të madhe me atë të përcaktuar në PZHU. Në hartën 10 janë vënë në fokus rastet kur në PRrU të caktuara traseja e rrugës apo profili ka pësuar ndryshim, por që në përgjithësi nuk ka ikur nga koncepti primar që ka pasur në PZHU. Për shembull në planin rregullues urban 'Fidanishte' me që në këtë PRrU propozohet edhe ndërtimi i lagjes së komunitetit RAE, atëherë është riorganizuar edhe rrjeti rrugor. Por në fund është arritur të bëhet lidhja mes udhëkryqit të stacioni 'Adem Jashari' dhe udhëkryqit në qendër të qytetit. Në rastin tjetër është shmangur traseja e bypass-it në jug të Bairit, por lidhja me Shupkoc është po e njëjta. Pjesa tjetër e infrastrukturës rrugore pajtohet plotësisht në mes të dy dokumenteve.

Në anën tjetër nëse bëjmë krahasimin e infrastrukturës rrugore të PRrU-ve dhe gjendjes ekzistuese të rrugëve ( fillimi i vitit 2018) atëherë mund të shihet që disa pjesë në zonën urbane kanë ikur nga koncepti i paraparë në PRrU-në përkatëse. Në hartën 11 janë vënë në fokus disa raste të këtyre shmangjeve. Për shembull karakteristik është rasti në Bair, ku shihet se pas ndërtimit të shtëpive,



banorët kanë ndërtuar rrugë që çojnë direkt në hyrje të shtëpive të tyre duke mos e ndjekur konceptin e rrugëve ëorre të parapara në PrrU. Pjesa tjetër e rrugëve në Bair është në harmoni me PRRu-në, këtu flitet për ato rrugë që tashmë janë të ndërtuara sepse një pjesë e rrugëve është ende e pandërtuar si dhe baypassi që lidhë me magjistralen për Prishtinë.

Në lagjen Sitnica rrugët janë deri diku në harmoni, por ka rrugë të tjera të shtruar, të cilat nuk janë të parapara në plan por shihet që janë rrugë që lidhin shtëpi banimi me rrugët lokale. Gjithashtu në pjesën lindore të kësaj lagje është ndërtuar infrastrukturë e re rrugore e cila lidhë lagjen me zonën e bizneseve. Në lagjen Fidanishte ashtu sic është spjeguar më lartë është krijuar infrastrukturë e re rrugore përkitazi me ndërtimin e lagjes së komunitetit RAE. Megjithatë rruga e paraparë lidhëse në mes të lagjes RAE dhe rrugës Ibri që con në Suhadoll, tanimë nuk është e mundshme të realizohet për shkak të ndërtimit të pishinave dhe hotelit në lokacionin përsaj lumit 'Ibër' i cili lokacion tangjenton lagjen RAE. Megjithatë për këtë ndërlidhje vecse ekzistojnë rrugë alternative të ndërtuara.

Sqarim: Në këtë raport është bërë vlerësimi i infrastrukturës rrugore sa i përket rrjetit në përgjithësi, por jo edhe dizajnit apo profilit të rrugëve ( si p.sh gjatësia, gjerësia, trotualet, shtigjet për bicikliste, gjelbërimi, vend-parkingjet etj.) Këto janë gjithashtu komponente të rëndësishme të cilat përcaktojnë funksionimin e mirë të trafikut brenda qendrës së qytetit.

Vlen të theksohet që çështjen e mobilitetit (infrastrukturën rrugore, transportin, ecjen, ciklizmin) në mënyrë më specifike komuna e Mitrovicës Jugore me mbështjetjen e UN-Habitat, është duke e trajtuar përmes hartimit të Planit të Mobilitetit të Qendrushëm Urban.

### **2.2.2 Hapësira publike dhe institucionale - Përputhshmëria mes propozimit dhe gjendjes ekzistuese**

Për ato 6 lagje të qytetit që kanë pasur plan rregullues, ka qenë më e lehtë zbatimi i projekteve në terren gjatë 10 vjeçarit të fundit. Mirëpo qytetin e Mitrovicës e karakterizon zhvillim i hovshëm edhe në pjesë të tjera të tij, aty ku kanë munguar planet rregulluese. Shembull për këtë është pjesa e epërme e Zhabarit të Poshtëm e cila lidhet me shtratin e lumit Ibër dhe tangjentohe me lagjen Fidanishte. Ndërtimi i liqenit artificial, prezenca e stadiumit olimpik 'Adem Jashari' në atë lokacion, ndërtimi i Kampusit të ri të Universitetit të Mitrovicës si edhe projekti i radhës në ndërtim e sipër, pishinat dhe hoteli 'Aqua Park' normalisht që e kanë ndikuar zonën përreth por edhe prioritizimin e kësaj zone si shumë atraktive për zhillim në të ardhmen. Në hartën 12 mëposhtë janë ilustruar se si ka qenë propozimi në PRRU-të sa i përket hapësirave të përbashkëta publike (në trajtim të vecantë gjelbërimi dhe shtretërit e lumenjëve) në krahasim me gjendjen e sotme në vitin 2018. Përkundër densifikimit të zonës qendër, një pjesë të Bairit dhe zonave përreth, në hartë mund të shihet që prania e gjelbërimit (sipërfaqe e lirë e ndërmjetme) në zonën urbane të qytetit është mjaftë e lartë.

Specifikisht 'Ura e Gjakut' dhe 'Sitnica' karakterizohen me banim individual dhe prezencë të lartë të gjelbërimit. Në shembullin ilustrues për zonën tek liqeni artificial, mund të shihet përputhje e konsiderueshme në mes të projekteve të parapara dhe atyre në zbatim. Por, projekti për liqenin artificial është projekt mëvete, pasi që Zhabari i Poshtëm nuk ka gëzuar plan rregullues. Pastaj, projekti 'Aqua Park' si zgjatje e projektit për liqenin artificial, është futur në zonën që funksionon me PRRU 'Fidanishte' duke i ndërruar destinim. Zhvillimi i hovshëm i kësaj zone, duhet të monitorohet me shumë kujdes, dhe me ligjin e ri në fuqi. Pas hartimit të PZHK-së dhe HZK-së duhet të konsiderohen planet e hollshme urbane dhe të kihet parasysh ndikimi i zonave përreth. Për shembull pozicionimi i lagjes së komunitetit RAE në këtë hapësirë duhet të trajtohet me kujdes në mënyrë që zona dhe zhvillimi të jenë gjithëpërfshirës dhe t'i shërbejnë të gjithë qytetarëve të zones pa përjashtim.

Harta 10: Kategorizimi i rrugëve sipas PZHU dhe PRRU-ve - Krahasimi i përpunueshmërisë

Kategorizimi i rrugëve sipas PZHU-se

Legjenda

-  Magjistrale
-  Rrugët kryesore
-  Bypass
-  Hukurudhë

Kategorizimi i rrugëve sipas PrrU-ve

Legjenda

-  PrrU 'Qendra'
-  PrrU 'Fidanishte'
-  PrrU 'Ilirida'
-  PrrU 'Bair'
-  PrrU 'Ura e Gjakut'
-  PrrU 'Sitnica'
-  Pajtueshmeri ne mes te PZHU dhe planeve rregulluese
-  Jopajtueshmeri ne mes te PZHU dhe planeve rregulluese
-  Lumi
-  Kufiri i vendbanimit 2009
-  Kufiri pas vitit 2013



Harta 11: Krahasimi i përputhshmërisë në mes të rrjetit të rrugëve të përcaktuara me PRRU-të dhe atyre ekzistuese (2018)

Kategorizimi i rrugëve sipas PZHU-se



Legjenda

-  Magjistrale
-  Rrugët kryesore
-  Bypass
-  Hukurudhë

Kategorizimi i rrugëve sipas PrrU-ve

Legjenda

-  PrrU 'Qendra'
-  PrrU 'Fidanishte'
-  PrrU 'Illiçide'
-  PrrU 'Bair'
-  PrrU 'Ura e Gjakut'
-  PrrU 'Sitnica'
-  Rruget e ndertuara ne zonen e planeve rregulluese deri ne vitin 2018

-  Lumi
-  Kufiri i vendbanimit 2009
-  Kufiri pas vitit 2013





- 1 Liqeni Artificial dhe hapësira e revitalizuar publike
- 2 Projekti 'Aqua Park'
- 3 Parkingu i ri
- 4 Lagja RAE
- 5 Hapësire e rezervuar (Institucionale- Universitare)
- 6 Shkolla Amerikane
- 7 Shkolla Speciale
- 8 Fushe Sportive
- 9 Parku rekreativ botanik



- 1 Liqeni Artificial dhe hapësira e revitalizuar publike
- 2 Projekti 'Aqua Park'
- 3 Parkingu i ri
- 4 Lagja RAE
- 5 Universiteti Publik i Mitrovices
- 6 Shkolla Amerikane
- 7 Shkolla Speciale
- 8 Fushe Sportive
- 9 Parku rekreativ botanik





### **3. PAJTUESHMËRIA E PROJEKTEVE KAPITALE DHE AKTIVITETEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ME PZHK/PZHU-NË**

### 3. Pajtueshmëria e projekteve kapitale dhe aktiviteteve të ofrimit të shërbimeve me PZHK/PZHU

Modeli i tretë i vlerësimit të këtij mjeti vlerëson nëse projektet kapitale dhe planet e aktivitetit janë në përputhje me qëllimet/objektivat dhe aktivitetet e PZHK-së. Për më tepër, mbledh informacione të veçanta lidhur me Projektet e Investimeve Kapitale (PIK-të) në bazë të departamentit të investimeve (sektorit), llojit të investimit (infrastrukturës ose shërbimit bazë), vitit dhe vendndodhjes. Informacione të tilla do gjeo-referohen dhe shtohen në Bazën e të dhënave të Integruar Komunale.

PZHK-ja e Mitrovicës ka tetë objektiva të përgjithshme, të cilat përfshijnë:

- Objektiva 1 (O1): Qyteti multietnik / bashkëpunimi

*Çështja themelore në fushën e multikulturës dhe bashkëjetesës është, që planifikimi të jetë i koordinuar dhe të bëhet në bashkëpunim me të dy pjesët e qytetit.<sup>20</sup>*

- Objektiva 2 (O2): Qendër regjionale ekonomike në veri të Kosovës

*Përkrahja dhe ngritja e kapitalit human, është një bazë e rëndësishme e prosperiteti ekonomik. Për këtë arsye, si detyrë qendrore del arsimimi dhe trajnimi i fuqisë punëtore, detyrë e cila duhet të përmbushet në mënyrë energjike.*

*“Thesari i Kosovës” na ofron si potencialin ekonomik nxjerrjen e xehes, mundësia e eksploatimit dhe përpunimit të së cilës duhet të shqyrtohen më saktësisht. Në PZHK, sipërfaqet për këtë destinim duhet të mbahen të lira.<sup>21</sup>*

- Objektiva 3 (O3): Infrastruktura sociale (arsimi dhe shëndetësia)

*Zgjerimi i hapësirave mësimore është tepër urgjentë. Si prioritare përmenden objektet, të cilat posedojnë më së paku hapësirë për një nxënës. Është e domosdoshme një planifikim i hapësirave shkollore përshirë edhe definimin e standardeve (në nivel shtetërorë).<sup>22</sup>*

- Objektiva 4 (O4): Infrastruktura teknike

*Furnizimi me ujë të pijes duhet medoemos të zgjidhet në kontekst regjional. Duhet që të përpilohet një koncept i zgjerimit të rrjetit të furnizimit me ujë të pijes, në të cilin do të përfshihen ato fshatra dhe nënqendra të cilat topografikisht mund të kyçen. Për zona të cilat nuk mund të përfshihen në rrjetin e ujësjellësit, duhet përpiluar konceptin për furnizimin me ujë të pijes (zënia e burimeve tjera të ujit të pijes). Furnizimi me energji elektrike duhet detyrimisht që të shqyrtohet në kontekste regjionale dhe shtetërore. Përkritazi me rrjetin e kanalizimit, nevojitet një koncept për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e tij.<sup>23</sup>*

- Objektiva 5 (O5): Infrastruktura e komunikacionit

*Prioriteti më i lartë i ipet kyçjes së nënqendrave me qytetin e Mitrovicës, me qëllim që popullata rurale të ketë qasje më të mirë në hapësirat për konsum si dhe institucionet shëndetësore e njëkohësisht kontribuohet në zvogëlimin e migrimit fshat - qytet.<sup>24</sup>*

- Objektiva 6 (O6): Kushtet për jetesë të shëndetshme- Ambienti dhe kualiteti i jetesës

<sup>20</sup> Ekstrakt i shkëputur nga PZHK (2009) mbi projektet prioritare të objektivave përkatëse, 217-224

<sup>21</sup> Po aty 20

<sup>22</sup> Po aty 20

<sup>23</sup> Po aty 20

<sup>24</sup> Po aty 20

*Gjatë sanimit të vendndodhjeve të mbeturinave, duhet ndërmarrë masa të menjëhershme për pengimin e emisioneve tjera të elementeve të dëmshëm.<sup>25</sup>*

- Objektiva 7 (O7): Zhvillimi i qëndrueshëm i vendbanimeve

*PZhK dhe PzHU përbëjnë bazën për përpilimin e planeve rregulative urbane. Prandaj është e rëndësishme që për kuartiret e qytetit, mirëpo edhe për nënqendrat pran qytetit që sa më shpejtë të përpilohen planet rregulative urbane.<sup>26</sup>*

- Objektiva 8 (O8): Zonat rurale dhe bujqësia

*Bujqësia paraqet një shtyllë të rëndësishme ekonomike për zonat rurale. Prodhimet bujqësore duhet që një përqindje të mundshme të rriten ndërsa prodhimet bujqësore duhet që në përputhje me kërkesat e tregut të përpunohen. Një intensifikim i ujitjes në zonën që përfshinë Ibër-Lepenci është kuptimplote.<sup>27</sup>*

Grupi punues tematik ka kontrolluar përputhshmërinë e projekteve me objektivat dhe aktivitetet e renditura në tri mënyra:

1. Nëse pas shqyrtimit të listës, projekti nuk përputhet as me objektivin as me aktivitetin, ata shënuan X në tabelën përkatëse.
2. Nëse pas shqyrtimit të listës, projekti nuk është në përputhje me aktivitetin, por është në përputhje me një nga objektivat, ata kanë shënuar O dhe numrin përkatës në tabelën përkatëse (për shembull O3 për Objektivin 3)
3. Nëse projekti përputhet me një nga objektivat dhe cilado nga aktivitetet (në disa raste më shumë se një aktivitet, grupi ka shënjuar me a. Pjesërisht përputhet - me të verdhë, b. Plotësisht përputhet - me të gjelbër).

Ju lutemi referojuni Aneksit 5 për informacione të mëtejshme për çdo drejtori/sector të adresuar në këtë raport.

Ndërsa, drejtoritë zbatuese të PIK-ut përfshijnë:

Drejtoria e Arsimit,

Drejtoria e Shëndetësisë,

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës,

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe

Drejtori të tjera, duke përfshirë:

Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit,

Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit,

Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës,

Drejtoria e Administratës etj.).

---


<sup>25</sup> Po aty 20

<sup>26</sup> Po aty 20

<sup>27</sup> Po aty 20

Sqarim: Në këtë raport nuk janë të përfshira të gjitha 14 drejtoritë sa ka komuna e Mitrovicës Jugore. Qëllimi ka qenë që të vlerësohen ato investime kapitale apo projekte të drejtorive përkatëse të shpërndara në tërë territorin e komunës në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria e tyre me objektivat dhe qëllimet e parapara për zhvillim në PZHK-në e vitit 2009. Të gjeturat do të kontribuojnë edhe në hartimin e PZHK-së së re të komunës, më saktësisht në orientimin e zhvillimit të saj dhe përcaktimin e objektivave dhe qëllimeve për 20 vitet e ardhshme. Ky ushtrim është realizuar me të dhënat nga 10 drejtoritë e lartpërmendura të cilat e kanë furnizuar grupin punues me të dhënat e tyre nga viti 2008 deri në vitin 2017. Gjithsesi gjetjet në këtë raport janë rezultat i punës së ndërmarrë nga grupi punues dhe gabimet eventuale mund të jenë të pranishme, por ky raport konsiderohet si pikënisje për punën që do të zhvillohet tutje.

**Grafiku 13: PIK-të në total nëpër drejtori**




Gjatë periudhës 2008-2017, në të gjithë departamentet e lartpërmendura në Komunën e Mitrovicës janë zbatuar në total 871 PIK apo projekte tjera. Siç shihet në Grafikon 13, më së shumti projekte janë zbatuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (433 PIK), ndërsa më së paku nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (22 projekte).

Grafiku 14 paraqet shpërndarjen vjetore nëpër drejtori, PIK-ve të zbatuara, gjatë periudhës 2008-2017. Vini re që nuk janë siguruar të dhëna për vitet 2008, 2009 dhe 2011 për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe vitet 2009 dhe 2011 për Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.


Ndërsa, Grafiku 15 paraqet ndarjen e PIK-ve në projekte infrastrukturore dhe të bazuara në shërbime, ku mund të shihet se të gjitha drejtoritë kryesisht kanë zbatuar projekte infrastrukturore.



Grafiku 14: PIK-të nëpër departamente në vit



Grafiku 15: PIK-të nëpër departamente sipas llojit/ funksionit



Nga të gjitha projektet e analizuara në kuadër të këtij raporti në periudhën 2008-2017, Objektivi 3 dhe Objektivi 5 janë përmbushur më së shumti.

<b>OBJEKTIVAT/STRATEGJITË E PZH/PZHU</b>	<b>Numri i projekteve</b>	<b>%</b>
<b>O1- Qyteti multietnik / bashkëpunimi</b>	<b>15 projekte</b>	<b>1.6</b>
<b>O2- Qendër regjionale ekonomike në veri të Kosovës</b>	<b>10 projekte</b>	<b>1</b>
<b>O3- Infrastruktura sociale (arsimi dhe shëndetësia)</b>	<b>219 projekte</b>	<b>23.4</b>
<b>O4- Infrastruktura teknike</b>	<b>89 projekte</b>	<b>9.5</b>
<b>O5- Infrastruktura e komunikacionit</b>	<b>449 projekte</b>	<b>48</b>
<b>O6- Kushtet për jetesë të shëndetshme- Ambienti dhe kualiteti i jetesës</b>	<b>31 projekte</b>	<b>3.31</b>
<b>O7- Zhvillimi i qëndrueshëm i vendbanimeve</b>	<b>40 projekte</b>	<b>4.27</b>
<b>O8- Zonat rurale dhe bujqësia</b>	<b>53 projekte</b>	<b>5.7</b>
<b>asnjërin objektiv</b>	<b>29 projekte</b>	<b>3.1</b>

Tabela 16/17. Përqindja e përmbushjes së objektivave/strategjive të PZH/PZHU me anë të projekteve kapitale dhe investimeve tjera

<b>O1 dhe O6</b>	<b>2 projekte</b>
<b>O1 dhe O7</b>	<b>1 projekt</b>
<b>O1 dhe O5</b>	<b>10 projekte</b>
<b>O1 dhe O4</b>	<b>9 projekte</b>
<b>O1 dhe O3</b>	<b>4 projekte</b>
<b>O1 dhe O8</b>	<b>1 projekt</b>
<b>O2 dhe O7</b>	<b>6 projekte</b>
<b>O3 dhe O6</b>	<b>1 projekt</b>
<b>O4 dhe O6</b>	<b>2 projekte</b>



Harta 13: Shpërndarja ndërsektoriale hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera në Komunën e Mitrovicës Jugore



**Zonat me 1 deri ne 5 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Rrzhanë
- Selac
- Ofçar
- Batahir
- Ziaçë
- Vidishiq
- Melenicë
- Kovaqicë
- Stranë
- Koprivë
- Dedi
- Zabergjë
- Magjerë
- Kaçandoll
- Mazhiq
- Tërrstenë
- Zasellë
- Frashër
- Verrnicë
- Broboniq
- Vidimiriq

**Zonat me 6 deri ne 10 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Bare
- Bajgorë
- Vinarc i Poshtëm
- Lushtë

**Zonat me 10 deri ne 15 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Rahovë
- Vllahi
- Kutllovc
- Mitrovicë Veriore

**Zonat me 16 deri ne 20 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Koshtovë

**Zonat me 31 deri ne 60 projekte ne periudhen 2008-2017**


- Kçiq (I madh dhe i vogel)

**Zonat me 150 deri ne 250 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Mitrovica (perفشire gjithë zonen urbane)

**LEGJENDA:**

- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte)
- 61-100 (projekte)
- 101-150 (projekte)
- 150-250 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2017







### 3.1 Drejtoria e Arsimit

Gjatë periudhës 2008-2017, Drejtoria e Arsimit investoi në 137 projekte. Siç paraqitet në Grafikon 16, më së shumti projekte PIK (40 projekte) janë kryer në vitin 2012, kurse më së paku (1 projekt) në vitin 2014.

Grafiku 16: PIK-të e Drejtorisë së Arsimit në vit




Grafiku 17: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimit



Sa i përket llojit të investimeve, shumica e projekteve (134 prej tyre) ishin infrastrukturore (p.sh. ndërtesat ose anekset e reja, rinovimet dhe sigurimi i furnizimeve) kurse pjesa tjetër (3 projekte) ishin të bazuara në shërbime (p.sh. krijimi i qendrave ose klubeve të reja).

Ndërsa, sa i përket vendndodhjes, shumica e projekteve (71 prej tyre) ishin të përqendruara në zonën urbane të Mitrovicës. Investimet e mbetura shpërndahen nëpër fshatra siç tregohet në Grafikon 18 dhe Hartën 9. Vlen të theksohet se 14 projekte nuk përmendin një vendndodhje të caktuar.

Grafiku 18: PIK-të e Drejtorisë së Arsimit për vendbanim





**Zonat pa investime ne periudhen 2008-2017**

- Rrzhanë
- Ofçar
- Batahir
- Batahir
- Ziaçë
- Dedi
- Vidishiq
- Kovaqicë
- Tërrstenë
- Kutllovc
- Stranë
- Suhadoll
- Zhabar i Poshtem
- Koprivë
- Broboniq
- Lushtë
- Vërrnicë
- Zasellë

**Zonat me 1 deri ne 5 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Selac
- Vllahi
- Magjere
- Zabërgjë
- Bare
- Bajgorë
- Kaçandoll
- Stantërg
- Mazhiq
- Rashan
- Vidimiriq
- Koshtovë
- Vinarc i Poshtëm
- Frashër
- Frashër i vogel
- Kçiq i Madh
- Kçiq i Vogël

**Zonat me 10 deri ne 15 projekte ne periudhen 2008-2017**


- Rahovë
- Tuneli i parë

**Zonat me 31 deri ne 60 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Mitrovica (perfshire gjithë zonen urbane)

**LEGJENDA:**

- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2017






PIK-të e Drejtorisë së Arsimit bien në **Objektivin 3 - Infrastruktura Sociale (arsimi dhe shëndetësia)**, duke adresuar në mënyrë të veçantë:

- Rritjen e kapaciteteve të ndërtesave shkollore dhe përmirësimin e inventarëve (pajisjeve),
- Ndërtimin e ndërtesave parashkollore.

Të gjitha projektet adresojnë nën-objektivin e parë, pasi që gjatë periudhës 2008-2017 nuk është ndërtuar asnjë parashkollor apo kopsht i ri. Nga 137 projekte, 24 përputhen plotësisht me një ose dy aktivitete specifike, kurse gjashtë përputhen pjesërisht. Projektet e mbetura përputhen me Objektivin 3 në përgjithësi, por jo me aktivitete specifike.


**Grafiku 19: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë së Arsimit me Objektivin 3**




### 3.2 Drejtoria e Shëndetësisë

Gjatë periudhës 2008-2017, Drejtoria e Shëndetësisë ka investuar në gjithsej 66 projekte. Shumica e projekteve janë kryer gjatë viteve 2011 (13 projekte) dhe 2012 (12 projekte).

**Grafiku 20: PIK-të e Drejtorisë së Shëndetësisë në vit**



Grafiku 21: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimit



Shumica e projekteve të investuara (89.4% ose 59 projekte) janë infrastrukturore (duke përfshirë rinovimet e ndërtesave të kujdesit shëndetësor, anekset e reja, rregullimet e oborrit dhe të objekteve të tjera, veturat e ambulancës, dhe inventare të tjera të ndërlidhura), ndërsa pjesa tjetër (10.6% ose 7 projekte) janë të bazuara në shërbime (p.sh. sistemet e teknologjisë informative dhe mirëmbajtja e ndërtesave).


29 (43.9 %) e PIK-ve të kryera nga Drejtoria e Shëndetësisë gjenden në zonën urbane të Mitrovicës, ndërsa pjesa e mbetur nuk kanë një

vend të caktuar.


Nga 66 projekte, janë tri projekte të cilat përputhen plotësisht me një nga aktivitetet (përfshirë ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve të reja shëndetësore), dhe 17 pjesërisht në përputhje me një nga aktivitetet (ndërtimi i objekteve të QMF-së) brenda **Objektivit 3 - Infrastruktura sociale (arsimi dhe shëndetësia)**. Një projekt është plotësisht në përputhje me një nga aktivitetet (zgjerimi i rrjetit të telefonit dhe internetit) dhe pesë të tjerë pjesërisht në përputhje me një nga aktivitetet (zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm, gropat septike për fshatrat periferike) brenda **Objektivit 4 - Infrastruktura Teknike**.

Të gjitha PIK-të përputhen me Objektivin 3 në përgjithësi. Shtatë prej tyre janë në përputhje me Objektivin 3 dhe 4 në përgjithësi, dhe dy të tjerë (mirëmbajtja e ndërtesave të kujdesit shëndetësor) me Objektivin 3 dhe Objektivin 6.

Grafiku 22: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë për Shëndetësi me Objektivin 3



Grafiku 23: Përputhshmëria e PIK-ve të Drejtorisë për Shëndetësi me Objektivin 4







**Zonat pa investime ne periudhen 2008-2017**


- Ofçar
- Batahir
- Ziaçë
- Dedi
- Vidishiq
- Kovaqicë
- Tërrstenë
- Kutlllovc
- Stranë
- Koprivë
- Broboniq
- Lushtë
- Vërrnicë
- Selac
- Vllahi
- Magjere
- Zabërgjë
- Bare
- Bajgorë
- Kaçanoll
- Stantërg
- Mazhiq
- Rashan
- Vidimiriq
- Koshtovë
- Vinarc i Poshtëm
- Frashër
- Frashër i vogel
- Kçiq i Madh
- Kçiq i Vogël
- Rahovë
- Tuneli i parë

**Zonat me 31 deri ne 60 projekte ne periudhen 2008-2017**

Mitrovica (pershire gjithe zonen urbane)

**LEGJENDA:**


- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2017



### 3.3 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë

Gjatë periudhës 2008-2017, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë ka zbatuar 433 projekte. Viti 2017 ishte viti kur u zbatuan më së shumti projekte, 79 sosh (18.24% të PIK-ve në total).


**Grafiku 24: PIK-të e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në vit**




Shumica e projekteve (427 projekte ose 98,61%) janë infrastrukturore (p.sh. ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve, përmirësimi i sistemit të ujërave dhe kanalizimeve, vendosja e shenjave të rrugëve, përmirësimi i hapësirave publike, instalimi i ndriçimit publik etj.), ndërsa pjesa e mbetur e projekteve janë të bazuara në shërbime (hartimi i projekteve të investimeve kapitale).

Sa i përket vendndodhjes, pothuajse gjysma e të gjitha projekteve (48.73% ose 211 projekte) janë zbatuar në zonën urbane të Mitrovicës, 31.63% (137 projekte) në fshatra, 4.38% (19 projekte) brenda dy ose më shumë vendbanimeve dhe 15.24% (66 projekte) nuk kanë një vend të veçantë.


**Grafiku 25: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimeve**



**Grafiku 26: Vendndodhja e PIK-ve**



**Grafiku 27: PIK-të e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë për vendbanim**



Të gjitha projektet janë në përgjithësi në përputhje me **Objektivin 5 - Infrastruktura e komunikacionit rrugor**, duke respektuar pjesërisht veprimtarinë e trajtimit të rrugëve sipas prioriteteve, nevojave dhe realizueshmërisë së tyre.





**Zonat pa investime ne periudhen 2008-2017**

Rrzhanë  
Selac  
Ofçar  
Batahir  
Ziaçë  
Vidishiq  
Melenicë  
Kovaqicë  
Stranë  
Koprivë

**Zonat me 1 deri ne 5 projekte ne periudhen 2008-2017**

Dedi  
Zabergje  
Magjere  
Kaçandoll  
Mazhiq  
Terrstene  
Zaselle  
Frasher  
Verrnice  
Broboniq  
Vinarc i Poshtem  
Vidimiriq

**Zonat me 6 deri ne 10 projekte ne periudhen 2008-2017**

Vllahi  
Bare  
Bajgore  
Rahove  
Stanterg  
Lushte

**Zonat me 10 deri ne 15 projekte ne periudhen 2008-2017**

Kutllonc  
Koshtove

**Zonat me 31 deri ne 60 projekte ne periudhen 2008-2017**


Kçiq

**Zonat me 150 deri ne 250 projekte ne periudhen 2008-2017**

Mitrovica (perfshire gjithe zonen urbane)

**LEGJENDA:**

- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte)
- 61-100 (projekte)
- 101-150 (projekte)
- 150-250 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2017







### 3.4 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka investuar në gjithsej 20 projekte gjatë periudhës 2010-2017. Shumica e projekteve janë kryer në vitet 2012 (gjashtë projekte) dhe 2013 (pesë projekte). 21 nga projektet janë infrastrukturore (të tilla si ndërtimi i terreneve sportive dhe stadimeve, ndërtimi i qendrave të komunitetit, funksionalizimi i kinemasë së qytetit, inventari për bibliotekën e qytetit etj.), ndërsa pjesa e mbetur është e bazuar në shërbim (projekti kulturor për komunitete). 11 nga projektet janë të vendosura brenda zonës urbane të Mitrovicës, katër nëpër fshatra dhe pesë nuk kanë vend të veçantë.


**Grafiku 28: PIK-të e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport në vit**



**Grafiku 29: PIK-të e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport për vendbanim**



**Grafiku 30: Objektivat**



- Në përgjithësi përputhet me Objektivin 3
- Në përgjithësi përputhet me Objektivin 1&3
- Nuk përputhen

12 projekte përputhen me **Objektivin 3 - Infrastruktura sociale (arsimi dhe kujdesi shëndetësor)** në përgjithësi (por jo në mënyrë specifike me ndonjë nga aktivitetet e saj), tre projekte me **Objektivin 1 - Qyteti/ bashkëpunimi multietnik** dhe **Objektivin 3 - Infrastruktura Sociale (arsimi dhe kujdesi shëndetësor)** (por jo në mënyrë specifike me ndonjë nga aktivitetet e saj), kurse pesë të tjerat nuk janë në përputhje me asnjë nga objektivat dhe aktivitetet e tyre. Brenda atyre që përputhen me Objektivin 3 në përgjithësi, dy janë plotësisht në përputhje me një ose dy aktivitete, ndërsa dy të tjerë janë pjesërisht në përputhje me një nga aktivitetet. Ndërsa, të tre projektet në përputhje me Objektivat 1 dhe Objektivin 3 plotësisht përputhen me një ose dy nga aktivitetet e tyre





**Zonat pa investime ne periudhen 2008-2017**

- Rrzhanë
- Selac
- Ofçar
- Zabërgje
- Vllahi
- Batahir
- Ziaçë
- Magjere
- Melenice
- Kaçandoll
- Stanterg
- Rahove
- Dedi
- Vidishiq
- Kovaqicë
- Tërstenë
- Rashan
- Shupkovc
- Frasher
- Frasher i Vogel
- Kutlllovc
- Stranë
- Koshtove
- Vinarc
- Koprivë
- Broboniq
- Lushtë
- Vërrnicë

**Zonat me 1 deri ne 5 projekte ne periudhen 2008-2017**


- Bare
- Bajgorë
- Mazhiq
- Vaganicë
- Kçiq i Madh

**Zonat me 10 deri ne 15 projekte ne periudhen 2008-2017**

Mitrovica (perfshire gjithe zonen urbane)

**LEGJENDA:**


- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2017




### 3.5 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Gjatë periudhës 2008-2018, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka zbatuar 52 projekte, 50 prej të cilave ishin infrastrukturore dhe dy të bazuara në shërbime. Projektet u shpërndanë kryesisht në këto vende: Bajgorë, Bare, Batahir, Broboniq, Dedi, Kaçandoll, Kçiq i Madh, Koprivë, Koshtovë, Kovaçicë, Kutllovc, Lushtë, Maxherë, Mazhiq, Melenicë, Mitrovicë, Ofqar, Rahovë, Rasha, Rzhane, Selac, Stantërg, Stranë, Svinjarë/Frashër, Tërstenë, Vaganicë, Vërbnicë/Vërrnicë, Vidishiq, Vidomiriq/Vidimriq, Vinarci i Ulët, Vllahi, Zabërgjë, Zijaqë, Vinarci i Epërm, Kçiq i Vogël.

**Grafiku 31: PIK-të e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në vit**



**Grafiku 32: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimeve**



- Në përputhshmëri të plotë
- Në përputhshmëri të pjesshme
- Përputhshmëria e përgjithshme

Të gjitha projektet bien në **Objektiv 8 - Zonat rurale dhe bujqësia**. Nga 52 projekte, 27 përputhen plotësisht me një (p.sh. pyllëzimi, mbështetje për fermerët me bimë, makineri, serra dhe pajisje të tjera) apo dy (p.sh. mbështetje për bimët mjekësore aromatike dhe për kultivues të arrave) aktivitete të Objektivit 8, nëntë përputhen pjesërisht me një nga aktivitetet (p.sh. mbështetje për bletarët, restaurimi i ndërtesave me karakter turistik, rritja e plantacioneve të arrave) dhe 16 përputhen në përgjithësi me objektivin, por jo me ndonjë nga aktivitetet e tij specifike.






Harta 18: Shpërndarja hapësinore e PIK dhe investimeve të tjera- Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

**Zonat me 31 deri ne 60 projekte ne periudhen 2008-2017**

- Bajgorë
- Bare
- Batahir
- Broboniq
- Dedi
- Kaçandoll
- Kçiq i Madh
- Koprivë
- Koshtovë
- Kovaqicë
- Kutllovc
- Maxherë Mazhiq
- Melenicë
- Ofqar
- Rahovë
- Rashan
- Rzhanë
- Selac
- Stantërg
- Stranë
- Suhadoll
- Frashër
- Tërstenë
- Vërrnicë
- Vidishiq
- Vidimriq
- Vinarc i Ulët
- Vllahi, Zabërgjë
- Zhabar i Epërm, Zijaq
- Vinarc i Epërm
- Kçiq i Vogël

**LEGJENDA:**


- 0 (projekte)
- 1-5 (projekte)
- 6-10 (projekte)
- 10-15 (projekte)
- 16-20 (projekte)
- 21-30 (projekte)
- 31-60 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2018




### 3.6 Drejtoritë e tjera

Drejtoritë e tjera që kanë investuar në projekte kapitale janë Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit, Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Administratës etj. Gjatë periudhës 2008-2017 këto drejtori kanë zbatuar gjithsej 161 projekte, shumica e të cilave janë të vendosura në zonën urbane të Mitrovicës. Numri më i madh i projekteve të zbatuara është 29, i realizuar në vitin 2010.

Grafiku 33: PIK-të e drejtorive të tjera në vit




Grafiku 34: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimeve



133 nga projektet ishin infrastrukturore dhe 28 të bazuara në shërbime. 137 projekte janë në përputhje me ndonjë nga objektivat, ndërsa 24 nuk janë në përputhje me objektivat dhe as me aktivitetet e tyre. Nga 137 projekte të përputhshme, tre përputhen me Objektivin 1; 10 me Objektivin 2; 4 me Objektivin 3; 22 me Objektivin 4; 16 me Objektivin 5; 29 me Objektivin 6; 40 me Objektivin 7; dhe 1 me Objektivin 8. 12 projekte të tjera përputhen me dy objektiva (dy me O1 dhe O6, një me O1 dhe O7, gjashtë me O2 dhe O7, një me O3 dhe O6 dhe dy me O4 dhe O6). Për informacion specifik referojuni Shtojcës 5.

Grafiku 35: Përputhshmëria e PIK-ve të drejtorive të tjera me objektivat







### 3.7 Investimet në Mitrovicën Veriore deri në vitin 2012

PZHK e Mitrovicës u publikua në vitin 2009, gjatë së cilës Komuna e Mitrovicës ishte një njësi e bashkuar. Qyteti u nda në Mitrovicën Jugore dhe atë Veriore në vitin 2013. Prej vitit 2008-2012, në Mitrovicën e Veriut janë zbatuar 34 PIK, shumica e të cilave janë realizuar në vitin 2011. Shumica e projekteve (33 PIK) ishin infrastrukturore (përfshirë rindërtimin e shtëpive të dëmtuara, trotualet e rrugëve, sistemin e ujësjellësit dhe përmirësimin e ndriçimit publik etj.), ndërsa një ishte i bazuar në shërbim (subvencione për qira të banesave).


Grafiku 36: PIK-të në Mitrovicën Veriore në vit



Grafiku 37: PIK-të infrastrukturore dhe të shërbimeve



Grafiku 38: Përputhshmëria me objektivat




Nga 34 projekte në total, 33 përputhen me një ose dy objektiva dhe të paktën një nga aktivitetet e tyre. Nëntë nga projektet janë në përputhje me **Objektivin 1 - Qyteti/ bashkëpunimi shumë etnik**, dhjetë me Objektivin 1 dhe **Objektivin 5 - Infrastruktura e komunikacionit rrugor**, nëntë me Objektivin 1 dhe **Objektivin 4 - Infrastruktura Teknike**, katër me Objektivin 1 dhe **Objektivin 3 - Infrastruktura Sociale (arsimi dhe kujdesi shëndetësor)**, një me Objektivin 1 dhe **Objektivin 8 - Zonat rurale dhe bujqësia**. Tre nga këto projekte janë plotësisht në përputhje me një nga aktivitetet e objektivave përkatëse, kurse 20 janë pjesërisht.



Harta 19: Investimet në veri të Mitrovicës deri në vitin 2012

Projektet ne vitin 2008
1.Rindërtimi i 19 shtëpive në Lagjen e Doktorëve
2.Asfaltimi i rrugës në Lagjen e Doktorëve
3.Kanalizimi i ujrave të zeza në Lagjen e Doktorëve
4.Rrjeti elektrik në Lagjen e Doktorëve
5.Rrjeti i ujësjellësit në Lagjen e Doktorëve
6.Asfaltimi i rrugës Suhadoll-Kroi i Vitakut
7.Asfaltimi i rrugës Suhadoll-Vidimriq
8.Asfaltimi i rrugës Vinarc i Epërm
9.Rindërtimi i 77 shtëpive në lagjen "Kroi i Vitakut"
Projektet ne vitin 2009
10.Asfaltimi i rrugës Vinarc i Poshtëm-Vinarc i Epërm
Projektet ne vitin 2010
11.Rrjeti i ujësjellësit në lagjen "Kroi i Vitakut"
12.Ndërtimi i shkollës në Suhadoll
13.Subvencionimi për mjellje pranverore
14.Ndërtimi i rrugës me zhavor Vidimriq-Suhadoll-Kroi i Vitakut
15.Depoja në shkollën e Suhadollit
16.Rrethoja e oborrit të shkollës në Suhadoll
17.Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Kroi i Vitakut"
18.Rindërtimi i 19 shtëpive në lagjen "7 Shtatori"
19.Rindërtimi i 4 shtëpive në lagjen "Kodra e Minorëve"
20.Rindërtimi i 8 shtëpive në Lagjen e Boshnjakëve
21.Rindërtimi i 13 shtëpive në Suhadoll
Projektet ne vitin 2011
22.Ndërtimi publik në lagjen "Kroi i Vitakut"
23.Asfaltimi i rrugës "Driton Veliu" Suhadoll
24.Ndërtimi i rrugës me zhavor Gushavc
25.Rrjeti i ujësjellësit në Vinarc-Gushavc-Vidimriq
26.Terreni sportiv në shkollën e Suhadollit
27.Ndërtimi i ujësjellësit Gushavc-Vinarc
28.Ndërtimi i lidhjeve anësore në rrjetin e ujësjellësit në fsh. Vinarc
29.Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fsh. Gushavc
30.Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga trazirat
31.Pagesa e qirasë për familjet e zhvendosura nga Veriu
Projektet ne vitin 2012
32.Rindërtimi i 25 shtëpive në lagje të ndryshme
33.Asfaltimi i rrugëve dhe murit mbrojtës në Gushavc
34.Furnizim dhe material ndërtimor



**LEGJENDA:**

0 (projekte)
1-5 (projekte)
6-10 (projekte)
10-15 (projekte)
16-20 (projekte)
21-30 (projekte)
31-60 (projekte) - PER PERIUDHEN 2008-2012

## **4. PAJTUESHMËRIA E INVESTIMEVE PRIVATE (AKTIVITETET BANIMORE DHE EKONOMIKE) ME PZHK/PZHU-në**



#### 4. Pajtueshmëria e investimeve private (aktivitetet banimore dhe ekonomike) me PZHK/PZHU-në

Ky model vlerësimi vlerëson nëse banimi privat dhe investimet ekonomike janë planifikuar dhe zbatuar sipas modeleve të sugjeruara të PZHK dhe PZHU (si mbushja, rindërtimi, ruajtja etj.). Gjithashtu grumbullon të dhëna për kodin e ndërtesave të reja (ndërtesa legale ose ilegale), vitin e ndërtimit, funksionimin dhe informacione të tjera të ndërlidhura (si tipologjia, numri i kateve, indeksi i ndërtimit etj.).





Harta 20: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje dhe pa leje në komunën e Mitrovicës Jugore

**Zonat në të cilat shpërndahen ndërtimet me leje:**


- Mitrovica (përfshirë gjithë zonën urbane)
- Bare
- Bajgorë
- Rahovë
- Tuneli i parë
- Koprivë
- Kaçandoll
- Koshtovë
- Vinarc i Poshtëm
- Magjere
- Broboniq

**Zonat në të cilat shpërndahen ndërmet pa leje :**

- Mitrovica (përfshirë gjithë zonën urbane)
- Magjerë
- Melenicë
- Vidishiq
- Bare
- Bajgorë
- Mazhiq
- Stantërg
- Rahovë
- Tuneli i parë
- Lisicë
- Rekë
- Kutllovc
- Rashan
- Koshtovë
- Kciq (I madh dhe i vogël)
- Zasellë
- Frashër
- Vinarc i Poshtëm
- Lushtë
- Koprivë
- Vidimiriq
- Tërrstenë

**LEGJENDA:**

- Ndërtimet me leje
- Ndërtimet pa leje








LEGJENDA:

- ◆ Ndërtimet me leje
- Ndërtimet pa leje






#### 4.1 Ndërtimet private me leje ndërtimi


Gjatë periudhës 2009-2018, gjithsej 194 leje ndërtimi janë dhënë për ndërtuesit privatë në Komunën e Mitrovicës Jugore. Shumica e lejeve të ndërtimit (34) janë dhënë në vitin 2017, pasuar nga viti 2015 dhe 2016 (secila me 29 leje ndërtimi). Ndërkaq, gjatë periudhës 2013-2018, dhjetë leje ndërtimi u refuzuan/ mohuan.

**Grafiku 39: Ndërtimet private në vit dhe lloji i tyre**



Pjesa më e madhe e ndërtimeve private (154 leje ndërtimi ose 78% e të gjitha ndërtimeve private) ishin rezidenciale, ndërsa ato të mbetura (43 leje ndërtimi, 22%) ishin aktivitete ekonomike. Ndër ndërtimet rezidenciale, 92 leje ndërtimi (47%) ishin ndërtime individuale të banimit, ndërsa 2 leje ndërtimi (31%) ishin ndërtime për banim kolektiv. Pjesa më e madhe e ndërtimeve rezidenciale (76%) përfshinin ato të aktiviteteve ekonomike, përveç 37 të projekteve private (24%) të cilat ishin vetëm rezidenciale. Siç shihet në Hartën 17, shumica e këtyre ndërtesave janë të vendosura në zonën urbane të Mitrovicës dhe disa të tjera në fshatrat komunale, si Bare, Bajgore, Kovacice dhe Koshtove.

**Grafiku 40: Pjesa e ndërtimeve ekonomike dhe të banimit privat**








Harta 22: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve me leje në komunën e Mitrovicës Jugore

**Zonat në të cilat shpërndahen ndërtimet me leje:**

- Mitrovica (përfshirë gjithë zonën urbane)
- Bare
- Bajgorë
- Rahovë
- Tuneli i parë
- Koprivë
- Kaqandoll
- Koshtovë
- Vinarç i Poshtëm
- Magjere
- Broboniq

**Ndërtimet me leje në bazë të funksionit**




**Banimi në bazë të tipologjisë**



**LEGJENDA:**

- ◆ Ndërtimet me leje
- Ndërtimet pa leje







Nr.	Kodi i Objektit	Nr. i Parceles	Funksioni	Etazhiteti	Sip.bruto	Koordinatat hapësinore
351-4062	2388/1, 2388/2, 2388/3		Banim/Afarizem	B+P+6+Nk	600.0m <sup>2</sup>	7488968.870000000111759
351-5573	2008/0, 2009/2, 2010/1, 2010/2, 2010/3, 2010/4		Banim/Afarizem	B+P+6	438.0m <sup>2</sup>	7489344.830000000074506
351-5151	1353/1; 1354/2; 1354/10; 1355/1; 1355/2, 1356/1 & 1356/5		Banim/Afarizem	B+P+7-8	575.0m <sup>2</sup>	7489098.919999999925494
351-5424	501/3; 501/1; 501/2; 501/4; 501/5 & 501/6		Banim/Afarizem(Aneks)	B+P+8	507.0m <sup>2</sup>	7489365.379999999888241
351-7246	1461/0		Banim/Afarizem	B+P+6+Nk	290.0m <sup>2</sup>	7489397.500000000000000
351-1401	610/2; 611/1; 611/2 & 612		Banim/Afarizem	B+P+10	535.0m <sup>2</sup>	7489175.320000000298023
351-4183	1629/2, 1630, 1631		Banim/Afarizem	B+P+6-7	370.0m <sup>2</sup>	7489150.160000000149012
351-4258	1986/20		Banim/Afarizem	P+3	34.5m <sup>2</sup>	7489335.709999999962747

0 75 150 m






#### 4.2 Ndërtimet private pa leje ndërtimi

Sipas të dhënave të MMPH-së, në Komunën e Mitrovicës Jugore, nga fillimi i viteve 2000 deri në vitin 2015 janë ndërtuar 8,103 ndërtesa pa leje (lista mund të përfshijë gjithashtu objekte pa leje të ndërtuara gjatë viteve të 90-ta). Gjatë vlerësimit të PZHK-së të Mitrovicës, Grupi Punues 4 ka identifikuar 16 ndërtime të tjera në vitin 2016 dhe 19 në 2017 (nuk janë të gjeo-referuara në hartë, pasi që gjeo-portali ende përdor orto-foton e vitit 2012). Sapo faqja e gjeoportalit të përditësoj hartën, EPK-ja do të jetë në gjendje të përditësojë edhe bazën e të dhënave me koordinatat e duhura dhe ndërtesat pa leje (2016, 2017, 2018) do të reflektohen në hartë. Prandaj numri i përgjithshëm i ndërtesave të ndërtuara ilegalisht nga periudha pas luftës deri në vitin 2017 është 8.138.

Shumica dërmuese e ndërtimeve ilegale janë vetëm rezidenciale (për banim) (rreth 92%), të ndjekura nga ndërtime të tjera (1.5%), ndërtime komerciale (1.3%), ndërtime banesore dhe komerciale (0.8%) dhe ndërtime industriale (0.7%). 3.7% e ndërtimeve janë të pa-kategorizuara. Siç shihet në Hartën 19, shumica e këtyre ndërtesave janë ndërtuar në zonën urbane të Mitrovicës, por shtrihen edhe në fshatrat komunale, veçanërisht përgjatë vijës kufitare midis Kutllovcit dhe Rahovës.








Harta 24: Shpërndarja hapësinore e ndërtimeve pa leje në komunën e Mitrovicës Jugore

**Zonat në të cilat shpërndahen ndërrmet pa leje :**

- Mitrovica (perfshire gjithë zonen urbane)
- Magjerë
- Melenicë
- Vidishiq
- Bare
- Bajgorë
- Mazhiq
- Stantërg
- Rahovë
- Tuneli i parë
- Lisicë
- Rekë
- Kutllovc
- Rashan
- Koshtovë
- Kçiq (I madh dhe i vogel)
- Zasellë
- Frashër
- Vinarc i Poshtëm
- Lushtë
- Koprivë
- Vidimiriq
- Tërrstenë


**Ndërrimet pa leje në bazë të funksionit**



- BANIM
- EKONOMIKE
- BANIM dhe EKONOMIKE
- INDUSTRIALE
- TJERA
- TE PAKATEGORIZUARA

**LEGJENDA:**

- Ndërrimet me leje
- Ndërrimet pa leje



### Gjetjet dhe rekomandimet

#### 1. Pajtueshmëria me kornizën ligjore të planifikimit hapësinor

##### Të gjeturat kryesore:

- Pas vlerësimit të dokumentit sa i përket disponueshmërisë së të dhënave sipas 13 fushave specifike tematike nese i krahasojme me kerkesat në UA Nr. 11/2015, del se ofrimi i përgjithshëm i të dhënave në kuadër të PZHK-së së Mitrovicës Jugore është 6.5%, që do të thotë se nga 1,295 fushat specifike të kërkuara vetëm 84 fusha janë ofruar përderisa mungojnë 93.5%. Edhe të dhënat në disponim, janë kryesisht pjesërisht të disponueshme dhe shumica e tyre datojnë nga viti 2004-2007 cka do të thotë se duhet të azhurnohen apo të mblidhen nga fillimi gjatë hartimit të PZHK-së së, HZK-së dhe dokumenteve të tjera të planifikimit për Mitrovicën Jugore.
- Për të dhënat në dispozicion në PZHK mungon verifikimi i saktësisë së tyre, burimit të informacionit, vitit të të dhënave. Ka mungesë të protokolleve dhe mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit për kontrollin e të dhënave të komunës.
- Duhet theksuar se komunat përfshirë Mitrovicën Jugore nuk posedojnë me kapacitete humane por sidomos financiare për të mbledhur të dhënat në mënyre vetanake. Madje, edhe kur kanë mbështetje apo konsulencë ky proces është njëjtë i vështirë, duke qenë se pothuajse të gjitha të dhënat e kërkuara duhet të mblidhen nga fillimi dhe implikimet financiare janë të papërbalueshme nga kapacitetet buxhetore të komunës.
- Në këtë proces është vlerësuar edhe struktura e përmbajtjes së PZHK-se dhe lista dhe përmbajtja e pjesës hartografike të PZHK dhe PZHU, nëse përfshijnë seksionet e përcaktuara në UA Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal. Duhet pasur parasysh që PZHK/PZHU janë hartuar në vitet 2008/2009 dhe nuk mund të vlerësohen mbi përqindjen e zbatueshmërisë së struktures së lartëpërmendur dhe disponueshmërisë së hartave të kërkuara. Gjithsesi informatat nga ky vlerësim janë hap inicues drejt krijimit të bazës së të dhënave për planifikim hapësinor (komuna e Mitrovicës Jugore nuk posedon me këtë bazë të të dhënave) dhe do të jenë të dobishme në përcaktimin e seksioneve që mungojnë ose ato që duhet të përditësohen ne proceset e hartimit të dokumenteve të reja.
- Gjatë vlerësimit, grupet punuese komunale kanë hasur poashtu në mungesë të të dhënave brenda PZHK-së e të dhëna sipas të cilëve ata i kanë poseduar në drjetoritë përkatëse në kohën e hartimit të dokumentit. Këtu gjithsesi luan rol koordinimi brenda sektorëve të ndryshëm komunal dhe procesi gjithëpërfshires i hartimit të planit, ashtu sic e kërkon edhe korniza ligjore.

##### Rekomandimet:

- Gjetjet nga vlerësimi i PZHKP/PZHU janë hapi fillestar në procesin e mbledhjes së të dhënave që mungojnë. Kadastrri është pika fillestare për të dhënat hapësinore, pasi DPU ose sektorë të tjerë nuk posedojnë një bazë të dhënash hapësinore. Lista e të dhënave të kërkuara nga UA për PZHK propozohet të rishikohet dhe të dhënat të kategorizohen në të dhëna primare, sekondare dhe terciare. Pra, komuna mund të fillojë procesin e mbledhjes së të dhënave më të rëndësishme dhe ndërkohë të mbledh të dhëna të tjera siç kërkohet nga UA përkatëse.
- Komuna duhet të themelojë dhe të operacionalizojë bazën e të dhënave të integruar komunale (në pajtim me kërkesat e SPAK/MMPH). Ky proces përfshinë: a. hartimin e



Protokolleve dhe Mekanizmave të Menaxhimit dhe Monitorimit, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të verifikuara dhe të azhuruara në bazën komunale të të dhënave, b. Trajnimin e stafit komunal (ndër-sektorial) në përdorimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave.

- Fushat tematike dhe lista e hartave në PZHK duhet të hartohen bazuar në UA përkatëse<sup>28</sup>. Të dhënat e siguruara nga fushat përkatëse duhet të kenë koherencë, saktësi dhe përpunim brenda dokumentit të bazuar në burime të besueshme dhe të verifikuara. Të dhënat e ndryshueshme duhet të vazhdojnë të përditësohen në bazën e të dhënave të komunës, si dhe në bazën qendrore të të dhënave. Pas çdo faze të grumbullimit të të dhënave, EPK duhet të verifikojë përputhshmërinë e të dhënave hapësinore dhe jo-hapësinore me të dhënat në posedim të tyre, përpara se këto të dhëna të migrohen në bazën e të dhënave të komunës.
- Drejtoritë përkatëse duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në procesin e grumbullimit të të dhënave. Kompania konsulente për hartimin e PZHK-së së re duhet të jetë në bashkëpunim të ngushtë me EPK-në dhe sektorët komunalë gjatë hartimit të profilit komunal dhe drejtoritë komunale duhet të jenë burimi i parë i të dhënave. Procesi i hartimit të PZHK duhet të ndiqet me parimet e gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit duke përfshirë palët ndër-komunale, ndër-institucionale dhe palë të tjera të interesit.

## 2. Pajtueshmëria/Zbatimi i PZHK-së, PZHU-së dhe PrrU-ve

*Në dispozitat për zbatim (në PZHK por edhe në PZHU) përcaktohen udhëzime mbi çështjet e interpretimit të PZHK-se gjatë hartimit të planeve rregulluese dhe planeve tjera. PZHK është dokument bazë që shërben si udhërrëfyes dhe kontrollues i tërë procesit zhvillimor të qytetit për dy dekadat e ardhshme. Gjithashtu përcaktohet qartë se këto plane nuk duhet të kenë kontradikta me dispozitat e përcaktuara në PZHK.<sup>29</sup>*

Dokumentet e planifikimit

### Të gjeturat kryesore:

- PZHK dhe PZHU e Mitrovicës u hartuan në vitin 2009 nga të njëjtat kompani. Objektivat, qëllimet dhe strategjitë e përcaktuara në PZHK u përshkruan më tej në PZHU dhe në përgjithësi këto dy dokumente janë në pajtueshmëri. Pas kësaj, Mitrovica e Jugut hartoi 6 PrrU për zonën urbane të qytetit (Qendra, Fidanishte, Ilirida, Bairi, Ura e Gjakut, Sitnica). Përkundër faktit se në PZHK dhe PZHU u theksua hartimi i planeve rregulluese për Shupkovc, Shipol dhe të tjerë, këto zona kanë vazhduar të zhvillohen përkundër mungesës së planeve rregulluese.
- Në këtë vlerësim është shikuar nëse kushtet e ndërtimit dhe konceptet hapësinore/zhvillimore të përcaktuara në PrrU, përputhen me kushtet e zhvillimit të përcaktuara në PZHK dhe PZHU. Anipse lagjet tjera të zonës urbane nuk kanë pasur plane rregulluese, disa nga to kanë pasur zhvillim të hovshëm gjatë viteve të fundit. Sa i përket destinimit të tërësive hapësinore sipas 6 PrrU-ve ato janë dukshëm në përputhje me PZHU-në, me disa ndërrime të vogla destinimi në nën-grupe urbane, bie fjala në Bair, Fidanishte apo Sitnicë por pa ndryshuar konceptin fillestar.
- Dallime në mes të PZHU dhe PrrU-VE hasen tek përcaktimi i kushteve të ndërtimit, me theks të vecantë PrrU 'Qendra' dhe një pjesë e PrrU 'Bairi'. Kur krahasoheshin kushtet e ndërtimit

---

<sup>28</sup> Po aty 1

<sup>29</sup> PZHK, p. 234

të përcaktuara në PZHU dhe kushtet e ndërtimit të sipërfaqes së mbuluar nga PRrU-të, vetëm 4.5% ishte dallimi në mes të dy dokumenteve (kushte të ndryshme ose jo-pajtueshmëri). Vendimi i asamblesë komunale për të rritur koeficientin e ndërtimit me 1 linearisht në zonën qendrore, ndryshoi këtë përqindje. Ndryshimi i koeficientit linear ka ndikuar në zona të caktuara, sepse në disa raste kushtet kanë ndryshuar për 100% ndërsa në raste të tjera për 25%. Efekti më së miri mund të shihet në terren, ku zona qendër është dendësuar me ndërtime të larta, me siperqafe të pakta gjëlbërими, me mungesë të vendeve për parkim dhe me ngarkesë të theksuar të komunikacionit, kjo edhe si rrjedhojë e rritjes së numrit të banorëve.

- Në Mitrovicën e Jugut, projekti i liqenit artificial, zona e re me pishina dhe zona rekreative përgjatë lumit, kopshti botanik dhe kampusi i ri i Universitetit të Mitrovicës, kanë ndikuar jo vetëm në lagjen Fidanishte, por në të gjitha lagjet me të cilën Fidanishte tangjentohet.

#### **Rekomandimet:**

- Në proces të zbatimit të reformës ligjore, Mitrovica do t'i nënshtrohet procesit të hartimit të një PZHK-je më të detajuar (karakter strategjik), HZK-je më të specifikuar (karakter operacional), dhe planeve rregulluese të hollësishme (karakterin e rregullimit hapësinor) për zonat me interes për komunën. Gjetjet e këtij raporti do t'i shërbejnë Mitrovicës Jugore në procesin e hartimit të PZHK-së së re (gjetjet mbi të dhënat komunale për fushat tematike, Zbatimi praktik i objektivave/strategjive) dhe HZK-së së re (gjetjet mbi kushtet e ndërtimit, zhvillimi urban dhe efektet e këtyre kushteve në praktikë), ndërsa të dhënat mbi strukturën dhe zhvillimin e ri urban do të shërbejnë për të përcaktuar fushat për të cilat komuna do të hartojë plane rregulluese të hollësishme (gjetjet mbi ndikimin e investimeve kapitale në hapësirën urbane të qytetit).
- Në bazë të vizionit, objektivave dhe projekteve prioritare për zhvillimin e qytetit, komuna duhet të hartojë plane përkatëse për zonat që do të ndikohen nga ky zhvillim. Projektet që nuk përkojnë me prioritetet e përcaktuara në PZHK, projektet ad-hoc në pjesë të caktuara të qytetit duhet pasur parasysh që e ndikojnë jo vetëm lagjen ku zbatohen por edhe gjithë zonën përreth. Rrjedhimisht kushtet e përcaktuara paraprakisht për lagjen Ilirida, Qendra dhe kushtet që do të përcaktohen për Zhabarin e Poshtëm duhet të marrin parasysh zhvillimet në këtë zonë sepse kjo në të ardhmen do të ndryshojë edhe kërkesat e banorëve për destinimin e pronave të tyre.
- Ndryshimet në kushte ndërtimore apo koncepte zhvillimore nga asambleja komunale duhet të marrin parasysh impaktin që do ta kenë në terren. Kur për zona të ndryshme brenda një lagjeje janë të përcaktuara kushte të ndryshme ndërtimore, ndryshimi i këtyre kushteve nëse bëhet, duhet të ketë specifikimet për secilin rast të ndryshëm.
- Komuna duhet të krijojë mekanizma komunalë për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve hapësinore. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, Drejtoria e Inspektionit duhet të formojnë një grup drejtues për funksionalizimin e këtyre mekanizmave, ndërsa sektorët e tjerë komunalë që hartojnë projekte të tilla si Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë etj., duhet t'i vëjnë në zbatim këto mekanizma.

### **3. Pajtueshmëria e projekteve kapitale dhe aktiviteteve të ofrimit të shërbimeve me PZHK/PZHU**

#### **Të gjeturat kryesore:**

- Nga tetë objektivat/strategjitë e parapara në PZHK/PZHU të Mitrovicës përmes projekteve kapitale dhe investimeve të tjera, më së shumti janë përmbushur Objektivi 5 - Infrastruktura



e Trafikut me 48% dhe Objektivi 3- Infrastruktura Sociale (arsimi dhe shëndetësia) me 23.4%. Në komunë ka shumë investime të tjera që plotësojnë pjesërisht objektivat dhe rastet tjera që nuk përmbushin asnjë nga objektivat apo aktivitetet e parapara.

- Objektivat/strategjitë e tjera të PZHK/PZHU janë përmbushur plotësisht ose pjesërisht nga projektet në departamentet e tjera. Objektivi 1 - Qytet multietnik/bashkëpunimi, është prekur nga investimet në veri deri në vitin 2012, meqenëse qyteti më pas është ndarë në dy komuna dhe bashkëpunimi është zbehur.
- Projektet dhe investimet e të gjithë sektorëve komunal janë fokusuar kryesisht në infrastrukturë, shumë pak në shërbime.
- Projektet dhe investimet e të gjithë sektorëve komunal janë fokusuar kryesisht në zonën urbane të Mitrovicës (përfshijto drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), dhe shumë pak ose aspak në fshatrat veriore të komunës (Rrzhinë, Selac, Ofcar, Zabergjë etj.).
- Numri më i madh i projekteve të zbatuara në komunën e Mitrovicës Jugore është nga viti 2017, ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës ka zbatuar më së shumti prej tyre.

#### **Rekomandimet:**

- Në PZHK-në e re si dokument strategjik duhet të përcaktohen qartë objektivat për zhvillimin e qytetit dhe të njejtat të kthehen në strategji dhe plan të aktiviteteve (përfshirë implikimet buxhetore) për të zbatuar më pasë në praktikë projektet që do të përmbushin këto objektiva. Projektet e zbatuara duhet të përfshihen në raportet vjetore të cilat do të shërbejnë në monitorimin e aspekteve cilësore dhe sasiore në raport me objektivat/strategjitë. Kjo do të lehtësojë menaxhimin e procesit të zbatimit të dokumenteve të planifikimit.
- Pasi që qyteti i Mitrovicës është ndarë në dy komuna në vitin 2013, në strategjitë e reja të PZHK-së duhet të shikohet mundësia e bashkëpunimit me Mitrovicën Veriore, shkëmbimet, planet dhe shërbimet e përbashkëta (p.sh., adresimi i mobilitetit dhe infrastrukturës rrugore).
- Në objektivat/strategjitë e dokumentit të ri të planifikimit strategjik duhet t'i kushtohet rëndësi projekteve që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve përtej projekteve me natyrë infrastrukture.
- Përtej zonës urbane të Mitrovicës (e cila përfshinë 14 lagje të qytetit) projektet për zhvillim duhet të orientohen edhe në zonat tjera të komunës, përfshirë fshatrat. Në PZHK-në e re, duhet të mblidhen të dhëna mbi numrin e saktë të banorëve në secilin vendbanim, numrin e nxënësve etj, në menyre që investimet të planifikohen të bazuara në nevojë. Për shembull në fshatin Rrzhinë ku numri i banorëve nuk është i madh, planifikimi i një shkollë (në mungesë të nxënësve) do të ishte një investim i pabazuar.
- Drejtoritë komunale duhet të thellojnë bashkëpunimin e tyre në projektet strategjike komunale. Duke qenë se komuna kufizohet nga kapacitetet buxhetore që ka, ajo duhet të hartoj projekte të cilat do të tërheqin grante të ndryshme qeveritare dhe grante tjera, investitorë vendas dhe ndërkombëtarë. Partneritetet Publiko-Private duhet të shtyhen përpara.

#### **4. Pajtuëshmëria e investimeve private (aktivitetet banimore dhe ekonomike) me PZHK/PZHU-në**

##### **Të gjeturat kryesore:**

- Nga lista e ndërtimeve me leje dhe ndërtimeve pa leje ka një shpërpjestim të lartë mes tyre. Ndërkohë që gjatë vitit 2009-2018 ekzistojnë 194 leje ndërtimi të lëshuara në Komunën e Mitrovicës Jugore, nga ana tjetër sipas listës së MMPH-së janë 8138 ndërtime pa leje. Megjithatë, për ndërtimet pa leje, lista e MMPH-së përfshin periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2015 (me mundësinë që lista ka edhe ndërtime të fund viteve 90-ta, por që janë të paidentifikueshëm pasi që në këtë listë mungon viti i ndërtimit të tyre. Identifikimi i tyre dhe atyre pas vitit 2009 (pas miratimit të PZHK) ka qenë i pamundur). Gjithashtu gjatë procesit të gjeo-referencimi të këtyre ndërtimeve, disa prej tyre nuk kanë pajtueshmëri hapësinore.
- Nga gjithsej 194 leje të lëshuara për ndërtime private, 78% (47% banim kolektiv, 31% banim individual) e tyre janë lëshuar për banim kurse 22% e tyre kanë pasur funksion ekonomik. Shumica e këtyre ndërtesave janë të vendosura në zonën urbane të Mitrovicës dhe disa të tjera në fshatrat komunale, si Bare, Bajgorë, Rahovë, Tuneli i Pare, Koprivë, Kaqandoll, Vinarc i Poshtëm, Broboniq, dhe Koshtovë.
- Nga gjithsej 8138 ndërtime pa leje, shumica dërrmuese e ndërtimeve ilegale janë vetëm rezidenciale (për banim) (rreth 92%), të ndjekura nga ndërtime të tjera (1.5%), ndërtime komerciale (1.3%), ndërtime banesore dhe komerciale (0.8%) dhe ndërtime industriale (0.7%). 3.7% e ndërtimeve janë të pa-kategorizuara. Pjesa më e madhe e këtyre ndërtesave janë ndërtuar në zonën urbane të Mitrovicës, por shtrihen edhe në fshatrat komunale, veçanërisht përgjatë vijës kufitare midis Kutllovcit dhe Rahovës.
- Përderisa ky raport në disa raste ka konfirmuar harmoninë mes dokumenteve të planifikimit (sa për ilustrim, kushtet e ndërtimit të përcaktuara në PZHU janë plotësisht në harmoni me kushtet e ndërtimit në PRrU-në 'Sitnica') megjithatë gjendja në terren ka marrë kahje tjetër. Të gjitha ndërtimet në lagjen "Sitnica" nuk janë pajisur me leje ndërtimi përveç dy prej tyre. Duhet të shtohet gjithashtu se Sitnica para miratimit të PZHK-së në vitin 2009 ka qenë venbanim joformal dhe pikërisht mungesa e vitit të ndërtimit në bazën e të dhënave të MMPH-së nuk ofron mundësinë për të kuptuar se sa prej këtyre ndërtesave janë ndërtuar pas miratimit të PZHK-së dhe sa prej tyre pas miratimit të PRrU-së 'Sitnica' në vitin 2014.
- Në komunë mungon një bazë e konsoliduar e të dhënave mbi lejet ndërtimore, e cila do të duhej të ishte e harmonizuar dhe e menaxhuar nga bashkëpunimi i ngushtë i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Inspektionit. Në kuadër të këtij vlerësim, grupi punues i përberë nga zyrtarë të të dy drjetorive ka konsoliduar listën e ndërtimeve me të dhëna të përbashkëta dhe ka inicuar bazën e të dhënave në QGIS, e cila bazë duhet të konsolidohet dhe përditësohet tutje.

#### **Rekomandimet:**

- Të gjitha ndërtimet pa leje duhet t'i nënshtrohen procedurave të legalizimit. Pas aprovimit të Ligjit të Ri për legalizimin e ndërtimeve pa leje, komuna duhet të angazhohet në mobilizimin e qytetarëve në legalizimin e objekteve të tyre. Objektet e legalizuara duhet të futen në bazën e të dhënave tashmë të krijuar. Komuna duhet të ftojë të gjithë qytetarët që kanë ndërtuar në periudhën para viteve 2000 dhe nuk i kanë të legalizuara ndërtimet e tyre, të paraqiten në komunë, në mënyrë që komuna t'i identifikojë këto ndërtime dhe të procesohet tutje me procesin e legalizimit bazuar në ligj.
- Të gjitha kërkesat për leje të reja ndërtimore duhet të bazohen në kushtet e përcaktuara me planet rregulluese në fuqi përderisa komuna të hartojë Hartën Zonale Komunale. Rastet kur për zona të caktuara nuk ka plan rregullues, ndërtuesit duhet të pajisen me lejen dhe kushtet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit/Sektori për legalizim.

- Bazuar në gjetjet e këtij raporti, qoftë në rastin kur ndërtimet posedojnë leje qoftë në rastin kur nuk posedojnë, shumica e tyre kanë funksion banimi (78% me leje, 92% pa leje) dhe e përshkojnë kryesisht zonën urbane të qytetit. Kjo duhet të merret parasysh në procesin e hartimit të dokumenteve të reja të planifikimit duke qenë se ofrimi i kushteve të banimit në zonën urbane të qytetit, mund të afektojë migrimin fshat-qytet, cka në këtë rast është në kundërshtim me njërin nga objektivat e PZHK-së së vitit 2009.
- Drejtoria e Urbanizmit duhet të thellojë bashkepunimin me Drjetorinë e Inspektionit dhe të unifikojë mekanizmat në adresimin e ndërtimeve pa leje. Baza e të dhënave tashmë e krijuar, duhet të vazhdojë të përditesohet tutje bazuar në UA-të përkatëse që do të rrjedhin nga Ligji i Ri për Ndërtimet pa leje.

### Hapat në vijim

Nr.	Hapat/Aktivitetet	Përgjegjës
1	<b>Grumbullimi i të dhënave që mungojnë</b> të bazohet në të gjeturat nga vlerësimi i PZHK/PZHU pikënisje për	Kompania Konsulente
1.1	<b>Kadastri, pikënisje e të dhënave hapësinore, duke qenë se DPU apo sektorët tjerë nuk posedojnë me databazë hapësinore..</b>	
1.2	Hartimi i Protokolleve dhe Mekanizmave të Menaxhimit dhe Monitorimit, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të verifikuara dhe të azhurnuara në bazën komunale të të dhënave.	KOMUNA
1.3	Bashkëpunim i ngushtë mes <b>EKP-së, Kompanisë konsulente, UN-Habitat-it</b> dhe palëve tjera ndër-komunale, ndër-institucionale në procesin e hartimit të PZHK-së së re.	EKP, Kompania Konsulente, UN-Habitat
2	<b>Për të dhënat e kërkuara nga UA e PZHK-së</b> propozohet që të rishikohet lista e të dhënave të kërkuara, dhe të bëhet prioritizimi i tyre në të dhëna <b>primare, sekondare dhe terciare.</b>	MMPH
3	<b>Themelimi dhe operacionalizimi</b> i databazës së të dhënave hapësinore (në përputhje me SPAK/MMPH).	KOMUNA
3.1	<b>Krijimi i grupit punues komunal (ndër-sektorial)</b> për bazën e të dhënave komunale	KOMUNA, UN-Habitat
3.2	<b>Trajnimi i stafit komunal (nder-sektorial) në përdorimin dhe menaxhimin e databazës.</b>	KOMUNA, MMPH, UN-Habitat
3.3	Zhvillimi i <b>strukturës së bazës së të dhënave të integruar komunale</b> , gjegjësisht listën e <b>të dhënave grafike dhe atributive</b> ; Zhvillimi i <b>dataseteve</b> ;	UN-Habitat
3.4	<b>Mbledhja dhe migrimi i të dhënave</b> (Sipas raportit të vlerësimit të PZHK)	Kompania Konsulente
4	Të krijohen <b>mekanizma komunal</b> për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve hapësinore. <b>DPU, DF, DKGJP, DI</b> të formojnë grupin menaxherial për funksionalizimin e këtyre mekanizmave kurse drjetoritë tjera komunale të cilat hartojnë projekte të tilla si p.sh <b>DSHPI, DA, DSH</b> duhet t'i vënë në zbatim këto mekanizma.	KOMUNA
4.1	Objektivat e percaktuara ne PZHK duhet të <b>përfshijnë implikimet buxhetore</b> për të zbatuar më pasë në praktikë projektet që do të permbushin këto objektiva.	KOMUNA, Kompania Konsulente



4.2	Hartimi i formatit për <b>raporte vjetore</b> që të menaxhohet procesi i zbatimit të dokumenteve të planifikimit.	KOMUNA
4.3	Drejtoritë komunale, duhet të <b>thellojnë bashkëpunimin</b> mes vete mbi projektet strategjike të komunës.	

Sqarim: Më sipër janë listuar aktivitetet apo hapat e ardhshëm në fillimin e procesit të hartimit të PZHK-së. Për më tepër procesi dhe detyrat përkatëse të EKP-së, kompanisë konsulente dhe UN-Habitat janë më gjerësisht të shtjelluara në programin për hartimin e PZHK-së.

## KOMUNA E MITROVICËS JUGORE



Str. "Bedri Gjinaj"  
40000 Mitrovicë  
Tel: +383 28 532 104  
komuna.mitrovica@rks-gov.net

## INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME

### UN HABITAT

Ministries Building "Rilindja"  
10000 Prishtina, Kosovo  
Tel.: +383 38 200 32611  
info@unhabitat-kosovo.org

### PAX

Sint Jacobsstraat 12  
3511 BS Utrecht, The Netherlands  
Tel.: +31 (0)30 233 33 46  
info@paxforpeace.nl

### CBM

Bulevardi Isa Boletini 11-12  
400000 Mitrovica, Kosovo  
Tel.: +383 28530335  
info@cmbitrovica.org